

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

23.12.2020

Ora 18:00

***RENDI I DITËS***


*Projektakti “Rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.*

**PJESËMARRJA :**

- KQZ:
- Ilirjan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- Komisioni Rregulator:
- Ilirjana NANO Kryetar
- Arens ÇELA Anëtar
- Dritan CAKA Anëtar
- Helga VUKAJ Anëtar
- Muharrem ÇAKAJ Anëtar
- Staffi KQZ Y.Merkaj, M.Koja
- Parti Politike PD, LSI, PSD
- Vëzhgues:

**Znj.I.Nano:** Mirëmbrëma të gjithëve, të nderuar anëtarë të Komisionit Rregulator, i nderuar Komisioner Shtetëror të Zgjedhjeve, të nderuar përfaqësues të partive politike, përfaqësues të administratës të Komisionit Qendror të

*Zbardhi materialin e incizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioneri Rregulator*

*Dt.23.12.2020*

Zgjedhjeve. Nisim mbledhjen e Komisionit Rregulator e cila sot në rendin e ditës ka vetëm një pikë, shqyrtimin dhe miratimin e e projektvendimit “Për rregullat e raportimin të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”. Edhe ky akt ka ardhur me propozim të Komisionerit në përbushje të detyrimeve të tij ligjore, ne në përbushje të detyrimeve tona si Komision Rregulator po e marrim sot në shqyrtim. Përpara se ti jap fjalën Komisionerit doja të thoja vetëm dy fjalë. Është një akt shumë i rëndësishëm, është një akt i cili ka marrë një kohë të gjatë konsultimi, është një akt që ka ngjallur interes të shtuar, ndër të gjithë aktorët dhe faktorët që janë të përfshirë në proceset zgjedhore, që monitorojnë proceset zgjedhore, që direkt apo indirekt janë të lidhur me proceset zgjedhore. Sigurisht ky akt lidhet me disa ndryshime të rëndësishme të Kodit Zgjedhor të realizuara, të miratuara nga Kuvendi Shqipërisë gjatë vitit 2020. Besoj ka marrë një vëmendje, vëmendjen e duhur nga Komisioni Rregulator, nga të gjithë anëtarët e këtij Komisioni. Përpara se të filloj shqyrtimin e tij sipas rregullores, unë do të doja t'ia jepja fjalën Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve Zotit Ilirjan Celibashi për të prezantuar aktin dhe për të paraqitur në mënyrë të përbledhur relacionin që shoqëron atë faleminderit, zoti Celibashi!

**Z.I.Celibashi:** Mirëmbërëma të gjithëve. Atëherë edhe sikurse ju zonja Nano e thatë, ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor sollën risi në lidhje me raportimet e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, të agjencive dhe ose ndërmarrjeve shtetërore mbi kategoritë e veprimtarive të ndaluara si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore,

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioneri Rregulator*

*Dt.23.12.2020*

financiare dhe logistikës së administratës shtetërore para zgjedhjeve, në një periudhë të caktuar dhe gjatë fushatës zgjedhore. Qëllimi i këtij projektvendimi të propozuar nga ana ime si Komisioner Shtetëror është pikërisht marrja e masave, monitorimi dhe parandalimi i veprimitarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore financiare dhe logistike të institucioneve qendrore dhe vendore, si edhe të administratës shtetërore gjatë periudhës 4 mujore para datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve si dhe gjatë fushatës zgjedhore në mënyrë specifike për disa aspekte të veprimitarisë dhe të sjelljes së institucioneve shtetërore. Objekti i këtij projektvendimi është pikërisht përcaktimi edhe i rregullave për raportimin e veprimitarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, përcaktimi i kategorive të veprimitarive të ndaluara, procedura e shqyrtimit të tyre nga Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet për lejimin ose ndalimin e realizimit të këtyre veprimitarive si dhe masat administrative në rast të mosrespektimit të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe të këtij vendimi. Projektvendimi që u është propozuar është organizuar në 4 krerë dhe ka 13 nene. Projektvendimi përcakton qartë, përkufizon qartë cilat janë veprimitaritë e ndaluara të cilat përbëjnë kusht për ndalim nga ana e Komisionit Qendor të Zgjedhjeve. Në zbatim të këtij vendimi, subjekteve të përcaktuara nga ligji, u ndalohet kryerja e disa veprimitarive me karakter publik. Detyrimi ligjor bie mbi Kryeministrin, Zëvendëskryeministrin, ministrat dhe zëvendësministrat, kryetarët e bashkive dhe zëvendësat e tyre, drejtora të përgjithshëm të agjencive apo institucioneve në varësi të Kryeministrit, Këshillit të Ministrave, ministritive dhe zëvendës kategorive të sipërcituara. Projektvendimi parashikon të dhëna lidhur më ndërfaqen e raportimeve që është në përgjegjësi të Komisionit Qendor të Zgjedhjeve, procedurat dhe afatet e raportimit për veprimitaritë publike të të gjitha institucioneve apo dhe subjekteve më mirë le të themi të detyruar për të raportuar

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*


*Komisioneri Rregulator*

*Dt.23.12.2020*

për veprimtaritë publike. Ndërsa qaja është në shërbim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të institucioneve të tjera për ushtrimin e detyrave e të përgjegjësive të tyre ligjore sipas përcaktimit të kodit. Afati se kur ky raport mund të bëhet dhe kush janë subjektet e legjituara për të bërë këtë raportim janë të përcaktuara në mënyrë të detajuara në projektvendimin që u është propozuar. Gjithashtu projektvendimi përcakton masat dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore gjatë fushatës zgjedhore por pa u cënuar asnjë e drejtë apo liri kushtetuese. Projektvendimi përcakton vendimarrjen e Komisionerit Shtetëror kur konstatohet kryesisht ose me kërkesë të të tretëve se veprimtaria publike përbën veprimtari të ndaluar në kuptim të këtij vendimi. Gjithashtu përcaktohen edhe sanksionet administrative me këtë rast. Projektvendimi parashikon të drejtën që u njihet palëve të cënuara nga vendimi i Komisionerit Shtetëror për të bërë ankım në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda afatit të përcaktuara. Hartimi i këtij projektvendimi do ta them që ka një rëndësi thelbësore në përcaktimin e rregullave për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike si edhe kategorive të këtyre veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes së institucioneve në raport dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike. Në zbatim të ndryshimeve të Kodit Zgjedhor, kategorizimi i veprimtarive të ndaluara është bërë për të ndaluar ato praktika që në zgjedhjet e kaluara dhe këtu kam parasysh të gjithë zgjedhjet e shkuara me ndonjë përjashtim janë vërejtur fenomene të cilat mund të përkufizohen si shpërdorime të burimeve shtetërore. Prandaj ne kemi synuar bazuar në ndryshimet e reja të Kodit Zgjedhor që nëpërmjet vendosjes së shtrëngimeve ligjore, të shmangen në zgjedhjet e ardhshme dhe jo vetëm këto të 25 prillit të vitit të ardhshmë, të gjitha praktikat e anatemuara të viteve të shkuara në lidhje më sjelljen e institucioneve

*Zbardhi materialin e incizuar*

*Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*


*Komisioni Rregulator*

*Dt.23.12.2020*

publike gjatë fushatës zgjedhore apo dhe pak më përpara në lidhje me fondet publike, me administratën publike. Kjo në mënyrë që të evitohen edhe ato perceptime të gjëra të publikut sikurse janë investime fushate, rrugë fushate, asfalt fushate, certifikata pronësie për fushatën, etj. Për zbatiminin korrekt të këtyre detyrimeve ligjore, ndërfaqja që ka krijuar Komisioni Qendor i Zgjedhjeve siguron akses të lirshëm edhe për publikun e gjerë i cili ka mundësi të konsultojë të gjithë informacionin që lidhet në lidhje me veprimtaritë që zhvillojnë institucionet shqiptare nga niveli më i lartë deri te niveli i tij më i ulët për të marrë informacion në lidhje me këto veprimitari dhe mbi vendimarrjen eventuale të Komisionit Qendor të Zgjedhjeve ku është rasti për të vendosur ndalimin. Dua të them që ky projektakt ka marrë një konsutlim të gjerë jo vetëm nga përfaqësuesit e partive politike si të interesuarit drejt për së drejti në procesin zgedhor por edhe me aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile. Për këtë arsyе nga drafti i parë që ju është propozuar ka ndryshime pasi janë reflekuar, jo të gjitha portë themi në pjesën më të madhe dërrmuese do të theksoja gjithë ato rekomandime dhe propozime që janë dhënë qoftë nga përfaqësuesit e partive politike, po kështu edhe të shoqërisë civile. Mendoj që miratimi i këtij akti padiskutim që ka gjëra që mund të ishin shkruar ndryshe, mund të ishin thënë ndryshe por mendoj që në thelb tej pikëvështrimeve me formulimin e dispozitave të ndryshme të këtij akti, mendoj që në thelb ky akt përbën një risi domethënëse dhe do të vendosi mendoj, do të hapi një faqe të re në historinë e raporteve të administratës publike me zgjedhjet, faleminderit.

**Znj.I.Nano:** Faleminderit zoti Celibashi , Nisur nga rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregulator unë më së pari do të ftoja kolegët, anëtarët e Komisionit Rregulator të çelin diskutimin në parim dhe të flasin në parim mbi

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

projektvendimin. Më tej do t'u drejtohesha edhe përfaqësuesëve të partive politike. Për ju kush dëshiron ? Zonja Vukaj po, faleminderit.

**Znj.H.Vukaj:** Faleminderit zonja Nano. Ashtu siç dëgjuam zotin Celibashi të relatojë si dhe të n'a prezantojë aktin, ashtu si edhe ju e përmendët që ky është një akt shumë i rëndësishëm, i bashkohem këtij konstatimi dhe mund të them që është akti me një përmbajtje thelbësore për të garantuar normalitet dhe neutralitet të sjelljes së strukturave shtetërore në procesin zgjedhor. E për pasojë ky akt ashtu siç ne u konsultuam, u përpoqën që të gjejmë draftimin e duhur apo ta plotësojmë kur pamë se mund të kishte mangësi apo kishte nevojë për shtesa dhe ndryshime. Është ky akt që do të garantojë ose nuk do lejojë apo do eleminojë, nëse deri në fund si akt do të qëndrojë ashtu siç ne e kemi paraparë apo ne e kemi diskutuar, elemenimin e avantazheve të padrejta që partitë kryesisht në pushtet fitojnë përgjatë proceseve zgjedhore . Ky vërtetë mund të futet si një akt në histori por duhet thënë dhe duhet përmendur që garancitë ose sipari është çelur në vitin 2017 i dhënes së garancive me marrëveshje politike e më pas me ndryshime në Kodin Zgjedhor, në Kodin Penal e kështu jemi në këtë akt si rrjetojë e vazhdimit të mbivendosjes së këtyre garancirave të cilat nga një VKM po përfundojnë në një akt të Komisionerit Shtetëror të Zgjdhjeve. Ndaj këtu ne të gjithë sëbashku jemi përpjekur që në këtë akt të sjelli maksimalisht në përmbajtje garancitë e nevojshme dhe garancitë që mendojmë se mund të kenë ndikim në procesin zgjedhor dhe i kemi konsideruar që të gjithë së bashku në parim ose edhe ne përmbajtje si veprime të cilat do të konsiderohen si veprime të ndaluara. Në vijim do të thoja që akti ka , është përmbajtësor dhe do të përmendja faktin që jemi përpjekur që të mos keqkuptohet ose që të mos keqinterpretohet duke sjellë, po sjell një shembull që administraten shtetërore nuk duhet ta perceptojnë thjesht dhe vetëm në nocionet e administratës shtetërore po dhe në administratë publike plus edhe terma të tjerë të cilët rast pas rasti ose nen pas neni lë

*Zbardhi materialin e incizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*  
*Komisioneri Rregulator*  
*Dt.23.12.2020*


të përpinqemi ti sqarojmë qoftë edhe në parim apo do ta tregojmë me konsensusin tonë apo jo këtë pjesë. Faleminderit, kaq kisha në parantezë.

**Znj.I.Nano:** Faleminderit zonja Vukaj. Kolegët e tjera? Zoti Çaka?

**Z.D.Çaka:** Faleminderit zonja Nano, faleminderit edhe të gjithë anëtarëve, Komisionerit Shtetëror edhe të gjithë të ftuarve. Ashtu sikurse edhe parafolësit thanë është nga nga aktet e rëndësishëm që Komisioni Rregulator po shqyrton edhe ashtu siç edhe kolegia Vukaj citoi hera e parë ka filluar në vitin 2017 që të ketë një normim të këtyre irregullave në lidhje me veprimtarinë e institucioneve publike. Është VKM-ja e vitit 2017 e cila pati një normim, kuptohet që ka qënë një normim më i pjesshëm. Të njëjtën gjë ka bërë Këshilli i Ministrave dhe në vitin 2019, por besoj që ky akt është plotësimi jo vetëm i atyre akteve pararendëse por njëkohësisht ka shtuar edhe ato element që Komisioneri theksoi që gjatë zgjedhjeve të mëparshme janë konstatuar për të dhënë një garanci më shumë për çdo subjekt zgjedhor për një fushatë zgjedhore, por jo vetëm për një fushatë zgjedhore se kjo përfshin edhe për disa kufizime për periudhën 4 muaj përpara datës së zgjedhjeve. Duhet theksuar që rëndësia e këtyre kufizimeve ka ardhur në rradhë të parë që me Kodin Zgjedhor i cili është miratuar në korrik të këtij viti mbi bazën dhe të një marrëveshjeje të gjerë politike. Duke shtuar edhe elementët kufizues për disa institucione shtetërore dhe që ne po i normojmë dhe po i shtjellojmë më shumë. Kështu që vlerësojë edhe punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pra të administratës në draftimin e këtij akti dhe besoj se do krijojë premisa të mira jo vetëm në zgjedhjet e 25 prillit por do të krijojë një normë të re për çdo zgjedhje të cilat do të zhvillohen në Shqipëri. Faleminderit.

**Znj.I.Nano:** Zoti Çaka faleminderit. Kemi zotin Çakaj, po?

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioneri Rregulator*

*Dt.23.12.2020*

**Z.M.Çakaj:** Të nderuar kolegë të Rregulatorit, të nderuar pjesëmarrës, përfaqësuesë të partive politike, pjesmarrës në mbledhjen e Rregulatorit. Siç jeni njojur qëllimi i këtij projektakti siç e sqaroi dhe Komisioneri dhe kolegët është vendosja e rregullave paraprake në funksion të marrjes së masave për monitorimin dhe parandalimin, së pari identifikimin e veprimitarive të ndaluara dhe së dyti parandalimin e këtyre veprimitarive me qëllimin e vetëm që të gjitha palët garuese në një palë zgjedhje të vendosen në pozita të barabarta. Pra palët kanë rënë dakort sigurisht në funksion të dakordësisë politike që në do të vendosim një set rregullash me anë të cilave ne do hyjmë në këto zgjedhje në kushte të barabarta pra asnjëra nga, qoftë në qeveri apo qoftë në maxhorancë të mos marrë avantazhe apo privilegje të padrejta në raport me tjetrën në garë. Në këtë funksion janë vendosur, janë sankzionuar, së pari janë identifikuar qartë se kush konsiderohen veprimitari të ndaluara. Së dyti, janë identikuar qartë subjekte të cilat janë të ngarkuara nga Kodi dhe nga ky akt projektakt me identifikimin e veprimitarive të ndaluara dhe parandalimin e këtyre veprimeve dhe sigurisht janë përcaktuar në mënyrë të qartë edhe rregullat për monitorimin dhe më pas veprime te cilat i ngarkohen Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të sqaruar situatat. Në rastin konkret ajo çfarë konstatoj unë është fakti se sigurisht ky akt rrjedh edhe ka një origjinë nga vendimi i Këshillit të Ministrave të vitit 2017 i pasuar nga tjetër vendim i këshillit të Ministrave të vitit 2019 paçka se e dimë të gjithë si shkoi historia e votimeve apo zgjedhjeve vendore të vitit 2019 dhe nuk u vu shumë në përdorim. Përtej kësaj palët pavarsisht se ishin në pozicione të skajshme e gjetën gjuhën me njëri tjetri dhe me një dakortësi politike arritën ta sanskionojnë këtë dakortësi të tyre në nivel Kodi, pra neni 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor. Ajo për çfarë i ftoj unë kolegët, edhe këtë e kam bindje të brendshme që të diskutojmë dhe në vijim të gjejmë dakortësinë midis njëra tjetrës është që asnjë nga palët, pra ta shikojnë aktin me mirëkuptim dhe të mos japim avantazhe apo privilegje të

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*


padrejta qoftë në këto zgjedhje qoftë në të gjitha zgjedhjet që do të zhvillohen në vijim, asnje nga palët nuk duhet të marrë avantazhe apo privilegje të padrejta për arsy se çdo palë që është në krye të qeverisë apo në krye të shtetit është thjesht administrator e buxhetit, e taksave të popullit shqiptar. Nuk kam ndonjë veçori të veçantë se jam unë në qeveri dhe do marr avantazhe, të drejta apo të padrejta, jam thjesht administrator i rradhës, ti je votuar për të bërë detyrat . në këtë kuptim ti je i detyruar të zbatosh së pari, të zbatosh detyrat për të cilat ti je angazhuar je zgjedhur e të gjitha dhe së dyti projektbuxhetin ti thjesht duhet ta mirëadministrosh jo ta keqadministrosh, nuk të është dhënë ty për ta përdorur për privilegje në favor të një subjekti apo një subjekti elektoral .Kështu që në këtë kontekst ftoj edhe kolegët që ta shikojnë me objektivitet shqyrtimin dhe më pas miratimin e këtij projektakti.

**Znj.I.Nano:** Faleminderit zoti Çakaj. Po zonja Vukaj? Po, faleminderit.

**Znj.H.Vukaj:** Faleminderit sërisht. Vetëm pak sekonda do ju haja sa për të bërë më dije publikun se vi nga një eksperiencë e 2017 ku mu dha roli që të përfaqësoja ministrin teknik dhe të monitoroja pikërisht një situatë të ngjashme, ose presupozohet që do të ndodhë, pra të garantoja zhvillimin, mospërdorimin e adminstratës në keqfunksion apo në ndikim të zgjedhjeve elektorale të atij viti. Kështu gjithë veprimitaria ime dhe e kolegëve e asaj periudhe është e materializuar në një raport dhe e përshëndes me këtë rast Komisionerin që e përmendi që ne jemi referuar praktikave pararendëse por në të njëjtën kohë edhe kolegët që e mirëpritën të gjithë sygjerimet e mia dhe në të njëjtën kohë me objektivitet i vlerësuan padyshim duke marrë përbazë parimin e sigurisë juridike dhe atë të ligjshmërisë që këto raste janë raste të cilat përbëjnë fenomen në Shqipëri dhe në të njëjtën kohë kanë pasur ndikim dhe kanë dhënë ndikim. Kështu që faleminderit edhe një herë, mund të vazhdojë dikush tjetër.

*Zbardhi materialin e inçizuar*

*Merita DULAKU*




*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

**Znj.I.Nano:** Faleminderit zonja Vukaj. Dëshiron dikush tjetër nga anëtarët të flasë në parim rreth projektvendimit ? Apo unë po e kaloj fjalën te përfaqësuesit e partisë politike. Dikush nëse deshiron? Po, zoti Kaso po, ju lutem.

**Z.I.Kaso, përfaqësues i PD:** Faleminderit zonja kryetare. Do të bashkohesha edhe unë më ju për sa i përket fjalëve tuaja për rëndësinë e aktit nga njëra anë, pasi do të konsiderohej me të vërtetë një gur themeli për sa i përket një praktike të mirë dhe një standarti të mirë që mund të vendoset në këto zgjedhje për mos përdorimin ose mos keqpërdorimin e burimeve dhe resurseve të administratës publike por dhe të shtetit në përgjithësi në favor të atij që rëndon dhe abuzon me to pra që është subjekti politik që është në pushtet . Neni ose nenet e Kodit Zgjedhor që shërbejnë si bazë ligjore për këtë akt të ndërmarrë nga ana juaj janë risi në Kodin Zgjedhor në mënyrën se si ato janë parashikuar pasi kanë të bëjnë me ndryshimet e fundit dhe nëqoftëse ka një gjë që nuk është trumbetuar siç duhet ose nukka marrë relevancën që duhet nga ndryshimet që pësoi paketa e Kodit Zgjedhor ishin disa aspekte të cilët synonin dhe në këndvështrimin tim të paktën në letër kanë arritur që të përbushin disa nga rekomandimet e raporteve të fundit të ODIHR-it sië është edhe ai për mos keqpërdorimin e burimeve edhe resurseve njerëzore që në raportin e fundit në mos gaboj ishte ngritur në nivelin e rekomandimit prioritar numër dy. Prandaj rëndësia e aktit që ju ndërmerrni sot nuk është thjesht edhe vetëm formale por ka të bëjë drejtpërdrejtë më cilësine e zgjedhjeve të cilat mendohet që pas këtij akti nëse ky funksionon edhe në praktikë ashtu siç është menduar dhe që të funksionojë do të shënonim më të vërtetë një hop përpara cilësor për sa i përket standartit të zgjedhjeve dhe do te shihnim në raportin vijues të ODIHR-it dhe vlerësimin mbi efikasitetin e tij. Di që ka qënë një punë e vështirë dhe një process i vështirë jo vetëm dialogimi por edhe perfeksionimi të

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioneri Rregullator*


*Dt.23.12.2020*

mënyrës se si jane shkruar dhe janë hartuar dispozitat pasi nuk është e lehtë jo vetëm për sa i përket teknikës legislative por për shkak të rëndësisë dhe të risisë së aktit të harmonizosh dispozita të cilat synojnë ti vënë fre keqabuzimit të burimeve por nga ana tjetër duke lejuar administratën dhe institucionet shtetërore të kryejnë në normalitet të plotë ato detyra që ligji ua ka ngarkuar. Shpesh herë masa e abuzimit qëndron pikërisht mbi vijën e hollë që ndan, shpeshherë të padukshme që ndan pjesën e administrimit normal dhe të menaxhimit normal të punës së institucioneve dhe vënies në përdorim të institucioneve ose burimeve të tyre në funksion të fushatave zgjedhore. Prandaj, duke konsideruar sa delikat është ky akt dhe sa i rëndësishëm besoj që Rregullatori por edhe Komisioneri i cili e ka propozuar, e ka dakordësuar besoj unë një pjesë të ndryshimeve, kanë kryer një punë të lavdërueshme dhe shpresoj që akti të jetë efikas edhe në praktikë, faleminderit!

**Znj.I.Nano:** Faleminderit zoti Kaso. Kemi përfaqësues të tjerë të partive politike? Po, zoti Kaziaj po.

**Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI:** Faleminderit zonja Nano. Përshendetje të gjithëve. Për sa i përket pjesës së kohës kur na është përcjellë ky akt nuk kemi pasur kohën e mjaftueshme për shqyrtimin e tij nen për nen. Ne do kërkonim nga Rregullatori që në praktikat e dërgimit të aktit, pra subjekteve politike që mbrojnë interesa të caktuara të partisë vetë do të donim që të kishim kohën e mjaftueshme për përcjelljen e aktit. Na janë përcjellë dy relacione të ndryshme dhe akti që do të shkonim do merrnim vendimarrjen pak me vonë na është përcjellë në orën 17:10 minuta. Nga një shikim sipërfaqësor i aktit konstatojmë që ka mangësi të theksuara në pjesën e sanksioneve akti, ndonëse në frysë është korrekt dhe është i mirëpritur nga subjekti që po përfaqësoj. Pjesa e sanksioneve duhet të ishte më e rëndë, duhet të kishte sanskione te

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*


*Komisioni Rregulator*

*Dt.23.12.2020*

karakterit administrativ më të larta dhe penal. Do të duhet të ishte pasqyruar sipas mendimit tone dhe pjesa e atyre që janë rekomandime prioritare të OSBE/ODIHR-it. Po të shohësh faqen 27 të zgjedhjeve të 2017 rekomandimi përfundimtar dhe prioritare, rekomandohet krijimi i një strukture të posaçme, jo të ndikuar nga qeveria për monitorimin e kësaj pjese le të themi, të afatit 4 mujor nga zgjedhjet dhe një gjë e tillë duhet të ishte pasqyruar në këtë akt sipas mendimit tim. Po ashtu sikurse thashe sanksionet duhet të ishin të karakterit qoftë edhe penal. Personat që shkelin dispozitat e këtij akti duhet të ndëshkoheshin penalisht qoftë edhe për shpërdorim detyre. Kolegët Vukaj, Çaka dhe Çakaj morën praktikën e mirë që u nis lidhur me zgjedhjet për sa i përket vendimit të Këshillit të Ministrave nr 573/2017. Në atë rast ishte parashikuar një filter nga një task forcë bërë jo nga personat të partisë në pushtet ose qeverisë, ndonëse detyra dhe themi rekomandimet dhe i gjithë materiali voluminoz i bërë në përfundim të procesit zgjedhor nga ana e kësaj task force ka qenë një material profesional. Janë gjetur shumë shkelje, janë bërë shumë kallëzime penale por në fund të procesit nuk e di sa dijeni keni po nuk ka shkuar çdo gjë siç duhet. Fakti është që ky ka qënë një filter dhe duhet të miratohej një filter dhe në këtë akt, sipas meje dhe sipas subjektit që unë përfaqësoj. Kjo ka të bëjë drejt për së drejti me vetë fryshtë e aktit dhe me praktikat që Rregulatori në këtë rast, se do jenë praktika dhe për zjedhjet e mëvonshme, do të duhet të kishte pasqyruar sipas nesh.

**Znj.I.Nano:** Zoti Kaziaj unë ju falenderoj shumë për komentin. Më lejoni, jo për replikë, sepse në rradhe të parë ato komentet që ju bëni dhe profesionalizmi më të cilën i përcillni dëshmon se sa i rëndëssishëm është ky akt për ju dhe për të gjithë subjektet politike. Komisioneri shpjegoi pak më herët faktin që ka patur një draft të parë, por ndërkohë ka patur një fluks sugjerimesh, rekomandimesh nga subjektet politike dhe nga organizata të shoqërisë civile, ndërkohë është riparë akti. T'u bëj një pyetje ju lutem

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioni Rregulator*

*Dt.23.12.2020*

sepse neve si Rregulator na kanë ardhur dhe sugjerimet e subjekteve politike dhe shoqatave dhe të organizatave të shoqërisë civile. Ju si subjekt politikë keni paraqitur për draftin e parë sugjerime?

**Z.A.Kazaj, përfaqësues i LSI:** Nuk kemi paraqitur. Prisnim miratimin nen për nen, të kishim zërin tonë të paktën. Fakti është që nga drafti i parë deri më sot e nderuar kryetare me draftin përfundimtar që na është prezantuar sot ka ndryshime thelbësore le të themi, shtim, pakësim, ndryshim terminologje por ajo që është më rëndësishmja sipas subjektit që përfaqësoj kjo është domethënë një shtyllë shumë e rëndësishmë është sanksionimi i personave që shkelin këtë akt ose dispozitat e këtij akti.


**Znj.I.Nano:** Në fakt unë personalisht, por besoj se dhe gjithë anëtarët e Rregulatorit do ta çmonim shumë nëse do të na e kishe dërguar edhe më herët sygjerime dhe rekomandime. Lidhur me sa thatë për sanksionet, personalisht do të kem një propozim kur të vimë te neni sanksioneve, ndoshta edhe kolegë të tjerë. Por, në diskutimin në parim nëse ka dhe diçka tjetër për të thënë jeni i lirë të diskutoni.

**Z.A.Kazaj, përfaqësues i LSI:** Në diskutimin nen për nen do themi dhe më shumë e nderuar por nëqoftëse më lejoni për afatin e shkurtër kohor që kemi pas në dispozicion për tu njohur me këtë akt, do të donim që në diskutimin nen për nen Rregulatori ta relatojë aktin. Faleminderit.

**Znj.I.Nano:** Absolutisht. Përfaqësues të subjekteve të tjera politike kanë diçka ? Dakord, nuk kemi gjë tjetër lidhur me diskutimin në parim kështu që unë ftoj kolegët, anëtarët e Komisionit Rregulator të votojmë në parim projektaktin.

***Kush është dakord me projektin në parim?***

*Zbardhi materialin e incizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.A.Çela, z.D.Çaka, znj.H.Vukaj, z.M.Çakaj)


**Kundra:** s'ka

***Me pese vota pro akti miratohet në parim.***

Çelim diskutimet nen për nen. Sikundër Zoti Kaziaj e tha por ndërkohë me mbështetjen e të gjithë anëtarëve të Komisionit Rregulator për shkak të rëndësisë së aktit, pë shkak të impaktit të aktit, por për shkak edhe të, jo vetëm dëshirës por edhe përgjegjësisë për një transparencë maksimale, akti do të lexohet nen për nen në mënyrë që të shohim konkretisht ku kemi diskutime, ndryshime, shtesa, propozime per ndryshime dhe shtesa. Unë po filloj me **nenin 1, qëllimi dhe objekti**.

Po lexoj tekstin sikundër është paraqitur me propozim të Komisionerit. Qëllimi i këtij vendosja e rregullave në funksion të marrjes së masave, monitorimi dhe parandalimi të veprimtarive të ndaluara, i sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të institucioneve qendrore e vendore, si dhe të administratës shtetërore, gjatë periudhës kohore 4 muaj para zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve, me synim garantimin dhe sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike. Krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime partiake. Pika 2 e nenit 1. Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike qendrore, agjencive, enteve, dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, përcaktimi i kategorive të veprimtarive të ndaluara, procedura e shqyrtimit të tyre nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve për ndalimin e realizimit të tyre, si dhe masat administrative në rast të mosrespektimit të dispozitave të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe të këtij vendimi.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioni Rregulator*

*Dt.23.12.2020*

Atëherë në këtë moment çel diskutimi nen për nën. U lexua përbajtja e nenit të parë. Më lejoni të theksoj për pjesëmarrësit në mbledhje, edhe për publikun, edhe për mediat atë që zonja Vukaj e theksoi më herët, që vërtetë ka ndyshime nga drafti i parë në draftin e dytë, por kjo për meritën e propozimeve të shumta brenda për brenda Komisionit Rregulator do të veçoja propozimet e zonjës Vukaj dhe të zotit Çakaj. Fillojmë me diskutimin nen për nen. Sipas irregullores duhet më së pari t'ua jap fjalën përfaqësuesëve të partive politike për të bërë propozim konkret për shtesë ose ndryshim në nënин 1 të projektvendimit. Nëse dëshiron dikush të marrë fjalën është i lirë nga përfaqësuesit e partive politike. Mesa shoh jo. Kolegët, antarët e Komisionit Rregulator lidhur me nenin 1 kemi ndonjë propozim për shtesë apo ndonjë ndryshim? Edhe anëtarët e Rregulatorit nuk kanë propozime konkrete. Atëherë më lejoni të kalojmë në votimin e nenit 1.

***Kush është dakord me nenin 1?***

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.A.Çela, z.D.Çaka, znj.H.Vukaj, z.M.Çakaj)

**Kundra:** s'ka

***Me pese vota pro miratohet neni 1.***


Kalojmë te nen 2. Do më duhet t'i lexoj nenet janë të gjata, më lejoni ta them paraprakisht, por do të më duhet të lexoj nenet e plota dhe aty ku kolegët do të kenë propozime konkrete apo përfaqësuesit e partive do të kenë propozime konkrete, draftin e kanë para tyre, do të referohen me pikë, germë të nenit.

Atëherë, nen 2 përkufizime. Në këtë vendim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Administratë shtetërore", është:

- i. administrata nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, sipas nenit 1, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", ku përfshihen institucionet e përmendura në pikën 2, të nenit 4, të këtij ligji;

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioni Rregulator*

*Dt.23.12.2020*

ii. punonjës të administratës shtetërore, ndaj të cilëve zbatohet ky vendim, sipas statusit të tyre, janë nëpunës civilë dhe punonjës administrativë, në përputhje me përkufizimet e dhëna në nenin 4, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe punonjës të tjerë civilë, marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen me Kodin e Punës;

iii. punonjës policie, punonjës të forcave të armatosura, punonjës të shërbimit informative për sa kohë kryejsë veprimtari publike, punonjës të shërbimit të jashtëm të përmendur në nenin 3, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe punonjës të tjerë, statusi i të cilëve ose elemente të tjera rregullohen me ligje të posaçme, ndaj të cilëve, përveç dispozitave të përgjithshme të këtij vendimi, do të zbatohen edhe dispozitat e veçanta për secilën prej kategorive të përmendura, për çdo rast, në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë vendim.

b) “Veprimtari publike”, janë të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut, apo të medias në kuptim të pikës 1 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, të kryera nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim, si dhe ato që kanë në agjendë informimin në periudhën katërmujore para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rrëth tyre.


c) “Kodi Zgjedhor”, është ligji nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Atëherë neni 2 ka përbajtjen e porsalexuar nga ana ime. Do të ftoja përfqësuesit e partive politike të marrin fjalën nëse kanë konkretisht propozim për shtesë apo ndryshim. Zoti Kaziaj po?

**Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI:** Jemi dakord!

**Znj.I.Nano:** Zoti Kaso kishit ju diçka?

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

**Z.I.Kaso, përfaqësues i PD:** Jo, jo. Dakord!

**Znj.I.Nano:** Dakord, kolegët, anëtarët e Rregulatorit?

**Znj.H.Vukaj:** Vetëm diçka zonja Nano

**Znj.I.Nano:** Po.

**Znj.H.Vukaj:** Për të sqaruar që administrata shtetërore dhe për të mos krijuar atë mbivendosjen ashtu siç ne diskutuam pra slesh (/) publike, doja të sqaroja që administrata shtetërore e përfshin atë publike dhe të sqaroja për publikun e gjërë edhe mediat që administratë shtetërore janë edhe kabintetet e ministrave apo të emëruarëve politikë, si edhe punonjës të tjerë të cilët kryejnë veprimtari brenda institucioneve por nuk përbajnë statusin e nënpuniësit civil apo të një kategorie tjeter punonjësish, mund të jenë punonjës shërbimi apo punonjës të tjerë administrativë, Faleminderit.

**Znj.I.Nano:** Faleminderit zonja Vukaj. Kolegët e tjerë kanë ndonjë koment ose ndonjë propozim pë shtesë apo ndryshim? Me sa shoh jo. Atëherë ftoj anëtarët e Komisionit Rregulator të votojnë nenin 2 sipas përbajtjes së paraqitur në variantin e Komisionerit, **Kush është dakord me nenin 2?**


**Pro:** 5 (znj.Nano, z.A.Çela, z.D.Çaka, znj.H.Vukaj, z.M.Çakaj)

**Kundra:** s'ka

**Me pese vota pro miratohet nenii 2.**

Po lexoj nenin 3 më lejoni të them paraprakisht që nenii 3 është i gjatë. Nëse kam edhe mirëkuptimin e kolegëve, duke qenë se ka disa pikë të përfshira në nenin 3 më lejoni t'i

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioni Rregulator*

*Dt.23.12.2020*

them pjesë pjesë? Pra ta nis me pikën 1.1, 1.2 e kështu me rradhë? Mendoni që është më mirë apo ta lexoj në mënyrë integrale të gjithë nenin se ndoshta është më mirë?

**Z.M.Çakaj:** Unë propozoj që ta lexosh në mënyrë integrale të gjithë nenin. Kush nga anëtarët e Rregulatorit të ketë propozime, shtesa apo sugjerime ta japë gjithësecili.

**Znj.I.Nano:** Dakord. Faleminderit zoti Çakaj.

**Kreu 2 Kategoritë e veprimtarive publike të ndaluara**

**Neni 3** veprimtari të ndaluara. Pika 1: Në zbatim të këtij vendimi:

1.1 veprimtari të ndaluara për t'u promovuar janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo posacerisht në dispozicion apo transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë:

- a) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjetikës, të telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim dhe interes të publikut;
- b) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, kombëtare ose vendore më karakter social dhe ekonomik si edhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës, rinsë, sporteve si dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet, si dhe të infrastrukturës, në shërbim të interesit publik.
- c) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve për mbrojtjen e monumenteve dhe të objekteve të paluajtshme të karakterit arkeologjik, historik, kulturor e shkencor dhe të objekteve publike ose për mbrojtjen e objekteve të luajtshme me vlerë institucionale, historike, arkeologjike, kulturore ose shkencore;

*Zbardhi materialin e incizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*  
*Komisioni Rregulator*  
*Dt.23.12.2020*

- ç) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve strategjike, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) mbështetjen dhe promovimin e objekteve të rindërtuara ose në proces rindërtimi për shkak të fatkeqësive natyrore.


Pika 1.2 Përjashtimisht, në rastet e vendosjes së masave të jashtëzakonshme për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore apo epidemisë/pandemisë, nuk zbatohen përcaktimet e pikës 1.1 të këtij nenit për akte apo veprimitari të cilat synojnë marrjen e masave për përballimin e pasojave të këtyre. Ndjesë, ka një problem gjuhësor, për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore apo epidemisë/pandemisë.

Promovimi sipas pikës 1.1, të këtij neni, nuk cënon rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike në zbatim të ligjit nr.146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, si dhe rastet kur ndërhyrjet me projekte përkijnë me veprimtaritë mbrojtëse në shërbim të jetës, shëndetit apo pronës.

Pika 1.3 “veprimitari të ndaluara”, janë edhe ato veprimitari që përfshijnë:

- a) shpérndarjen në veprimitari publike të lejeve të legalizimeve, në periudhën katër mujore para datës së zgjedhjeve;
- b) shpérndarjen në veprimitari publike të akteve për regjistrimin e tokës bujqësore, certifikatave të pronësisë dhe çfarëdolloj titulli pronësie tjetër sipas legjislacionit përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë, si dhe të regjistimeve të tituve të pronësisë sipas ligjit nr.111/2018, “Për kadastrën” në periudhën katër mujore para datës së zgjedhjeve;
- c) vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njësive të vetëqeverisjes vendore,

*Zbardhi materialin e incizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioni Rregulator*

*Dt.23.12.2020*

apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital, kuota, aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit;


ç) përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore, qendrore dhe vendore brenda orarit të punës për veprimitari dhe/ose aktivitete për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimin në mënyrë të detyruar dhe të organizuar brenda orarit mësimor të nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar për veprimitari dhe aktivitete në funksion të zgjedhjeve, ose premtimin apo ofrimin e përfitimeve nëpunësve publikë ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimitari për qëllime zgjedhore, jashtë orarit të punës ose mësimit, si dhe ushtrimin e presionit ndaj tyre për këtë qëllim.

d) gjatë fushatës zgjedhore, marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë nga institacione në entet publike, shtesat në organikën në çdo lloj institucioni publik ose shtetëror apo emërimë provizore më përjashtim të rasteve të përligjura, konsiderohen raste të përligjura kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhoje e shkeljeve sipas legjisacionit përkatës ose marrja në punë bëhet sipas strukturës dhe organikës në fuqi para fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik, në përbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë.

dh) Kontrrollet dhe verifikimet e bizneseve tregtare dhe operatorëve në kundërshtim më procedurat ligjore dhe veprimitarinë institucionale.

**Pika 2 e nenit 3.** Kryeministri, administrata e tij, Zëvendëskryeministri, ministri dhe zëvendësministri, administrata e tyre, kryetari i bashkisë dhe zëvëndësi dhe administrata e tij, prefeketi dhe administrata e tij drejtori i përgjithshëm i agjencive apo institucioneve në varësi të Kryeministratit, këshillit të ministrave ose ministrit, drejtori i përgjithshëm, drejtorë të departamenteve, drejtorët e drejtorive dhe administratat respektive, drejtuesit dhe anëtarët e organeve kolegiale, enteve, bordeve, çdo drejtues i shoqërive tregtare në administrim nga shteti, si dhe në çdo ent ku shteti zotëron

*Zbardhi materialin e incizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioni Rregulator*

*Dt.23.12.2020*

aksione, kapitale, kuota apo emëron shumicën e organit mbikqyrës ose të organit administrues, titullari dhe zëvëndësi i tij për ndërmarrjen shtetërore gjatë periudhës 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarë do lloj forme në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi.

**Pika 3 e nenit 3** “Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi i akteve ligjore ose nënligjore, ose nxjerra e tyre me qëllim informimin e pulikut në lidhje me vendimmarrjen e institucionit miratues në faqen e tij zyrtare, të cilat parashikojnë dhëni e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si akte që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, faljen e kamat vonesave, të gjobave, të detyrimeve tatimore doganore vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhëni e pasurive a të shpërblimeve, përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore ose të epidemisë/pandemisë, apo ka si qëllim zbatimin e një detyrimi ligjor me karakter ndërkombëtar apo zbatimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

**Neni 3 pika 4** . Në zbatim të ndalimit të përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, Kryetari i Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave marrin masa për të mos vendosur ose propozojnë të mos vendosen në rend të ditës të institacioneve respektive për shqyrtim dhe miratim, aktet e përmendura në pikën 3 të këtij neni.

**Pika 5 e nenit 3.** Institucionet publike u krijojnë vëzhguesve dhe shoqatave të regjistruara në KQZ si vëzhguese të procesit zgjedhor, akses të plotë për të marrë informacion në lidhje me detyrimet ligjore të administratës publike, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për informimin e publikut dhe të këtij vendimi.

*Zbardhi materialin e incizuar*

*Merita DULAKU*

*Dulaku*

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

Sic ju thashë pak më herët, neni tre ishte pak i gjatë për shkak se mendoj është shterues për sa i përket veprimtarive të ndaluara subjekteve etj. Atëherë sipas rregullores, po ja jap fjalën së pari përfaqësuesve të partive politike, nëse kanë konkretisht shtesë apo ndryshim për propozim. Nuk shoh të ketë për neni tre nga përfaqësuesit e partive politike ndonjë propozim konkret për shtesa apo ndryshime.

**Z.A.Kazaj, përfaqësues i LSI:** Në qoftë se mundem zonja Kryetare?

**Znj.I.Nano:** Po, patjetër zoti Kazaj.

**Z.A.Kazaj, përfaqësues i LSI:** Në pikën një tre, gérma ç,..

**Znj.I.Nano:** Po një moment ju lutem. Po pika një tre, gérma ç, që në fund të fundit është tranzfozimi i nenit 91.

**Z.A.Kazaj, përfaqësues i LSI:** Flitet për përdorim fizik të administratës zgjedhore apo për përdorim, në këtë rast të themi i mjeteve të komunikimit elektronik, se mund të ketë të themi veprime me mjete të komunikimit elektronik që është gjithmonë një përdorim i administrarës shtetërore në zgjedhje. Mirë fizikisht nuk mund të shkojnë në thonjëza, por mund të përdorin mjete të mjaftueshme për të arritur qëllimin e tyre.

**Znj.I.Nano:** Atëhere, po i drejtohem Komisionerit si propozuesi i aktit.

**Z.I.Celibashi:** Ne nuk kemi bërë asnjë lloj kufizimi, kemi përfshirë çdo lloj përdorimi i cili është i papërshtatshëm i administratës zgjedhore dhe nuk është rasti

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*

*Dulaku*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*  
*Komisioneri Rregulator*  
*Dt.23.12.2020*

për të bërë një listë të përdorimeve të themi, pasi ajo çfarë e bënë të dallueshme një gjë të ligjshmë nga të paligjshmja, është përdorimi i paligjshëm dhe përdorimi i paligjshëm i administratës pavarësisht me çfarë mjeti dhe çfarë mënyre. Nuk ka të bëjë thjesht dhe vetëm me imponimin që ai të dalë në miting, po çdo gjë tjetër që eshtë imponuese kundrejt tij jashtë vullnetit të tij dhe në kundërshtim me statusin e tij, për qëllime elektorale, domethënë i përfshinë të gjithë gamën e mjeteve.

**Z.A.Kazaj, përfaqësues i LSI:** U nisa nga fakti, zoti Celibashi, për shkak se një punonjës i administratës, nëqoftë se del fizikisht në një të themi në mbështetje të një subjekti të caktuar ose të një kandidati të caktuar është lehtësisht i identifikueshëm deri diku, ndërsa përdorimi i mjeteve elektronike për arritjen e qëllimit është vështirësisht i kontrollushëm.


**Znj.I.Nano:** Po zoti Komisioner po ju..

**Z.I.Celibashi:** Nëse ishte për mua pyetja apo jo?

**Z.A.Kazaj, përfaqësues i LSI:** Po për ju.

**Z.I.Celibashi:** Po është e vërtetë kështu është realisht por ne me këtë rregullim këtë normim nuk e kemi përjashtuar. Nëse do verifikohet dhe kjo patjetër do konsiderohet si rasti kur është i dukshëm ky përdorimi fizik. Pra, të themi nëse referohesh që eshtë i imponuar për të bërë fushatë zgjedhore në facebook në mënyrë të imponuar për një subjekt të caktuar nëse kjo do verifikohet ose do vërtetohet patjetër njësoj është e njëjta gjë, po të jemi realisht kjo është e pamundur.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*


**Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI:** Thuajse e pamundur është.

**Znj.I.Nano:** Zoti Kaziaj nëse mundet të them diçka nga ana ime, por kjo buron jo thjesht si e kuptoj unë normën, po nga të gjitha diskutimet që kemi bërë gjithë këto ditë me kolegët. Në faktë duke lexuar neni 91, pika 2, të Kodit Zgjedhor, i cili është transpozuar pikërisht në këtë dispozitë të projektvendimit tonë. Ka dy momente ose e para është përdorimi i detyruar dhe bëhet fjalë për brënda orarit të punës, kështu që në këtë rastë përjashtohen mitingjet apo veprimet e partive politike dhe absolutisht ajo që thoni ju mundet të përfshihet në këtë lloj detyrimi brenda orarit të punës. Ndërkohë kemi dhe detyrime jashtë orarit të punës, por nga ana tjetër unë dua të sjell në vëmendje të kolegëve, në vëmendjen tuaj, medias, publikut një fakt që u trajtua më herët nga kolegët kur thamë që kjo iniciativë është vijim i iniciativave të më hershme. Unë dua të theksoj që në vitin 2017, ka ndryshuar dhe Kodi Penal, ku janë përcaktuar edhe përdorimi i detyruar të themi i administratës, unë nuk e kam saktësisht parasysh bëhet fjalë për neni 328, a, të Kodit Penal, pra të mos harrojmë që ato që nuk janë shkelje nuk i trajtojmë ne si shkelje administrative në çdo rast mund të referohen në Prokurori në qoftë se përbëjnë vepër penale ato raste të përdorimit të detyruar të administratës në fushatë zgjedhore për qëllime partiake. Atëherë...

**Znj.H.Vukaj:** Diçka tjetër të lutem?

**Znj.I.Nano:** Po po zonja Vukaj.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

**Znj.H.Vukaj:** Me sa dëgjova z. Kaziaj dhe e konsideroj jo vetëm palë të tretë, por dhe palë të interesuar nëqoftëse z. Kaziaj e lexon ashtu edhe si ekspert i fushës, druaj se mos na sjell probleme në leximin e palëve të tjera të cilat do të përfshihen si mekanizma zbatues në këtë akt. Kështu që z. Kaziaj nëqoftëse vërtetë e shikon me shqetësim dhe ka një propozim konkret se ku mund ta implementoj atë, le të na i qasi në këtë moment dhe pastaj e shqyrtojmë paraprakisht dhe nëse me vërtetë e përmbush shqetësimin e tij, apo norma duhet të lënë kështu dhe është shteruese?

**Znj.I.Nano:** Po patjetër zonja Vukaj, unë ftoj përfaqësuesit e partive politike, për propozime konkrete nëse kanë.


**Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI:** Sipas meje është mirë që një propozim i tillë të futet, të jetë pjesë e normës, duke propozuar konkretisht të themi përdorimin e detyrrur në fushatën zgjedhore të administratës shtetërore, qendrore apo vendore brenda orarit të punës, qoftë edhe me mjete të komunikimit elektronik për veprimitari dhe ose aktivitete për qëllime zgjedhore. Nuk e di nëse isha i qartë?

**Znj.I.Nano:** Pra, shtesa juaj është “edhe me mjete te komunikimit elektronik, “.. propozimi juaj ?

**Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI:** “..edhe dhe jo vetëm”.

**Znj.I.Nano:** Pra, kur thua “edhe me mjete të komunikimit elektronik” në fakt nënkupton që ka edhe të tjera, pra të përdorim pak edhe një gjuhë të përshtatshme në kuptimin e gjuhës ligjore, edhe me mjetet. Po e mbaj shënim sepse më duhet ta

*Zbardhi materialin e incizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

kaloj më tej për votim pastaj. Dhe kjo shështë brenda orarit të punës, tek rreshti i dytë i germës ç, apo jo?

**Z.A.Kazaj, përfaqësues i LSI:** Ekzakt e nderuar!

**Znj.I.Nano:** Ok, falemiderit! Përfaqësuesit e partive të tjerë parlamentare kanë propozim konkret? Atëherë kolegët anëtarë të Rregulatorit, zoti Çaka.

**Z.D.Çaka:** Atëherë, unë nuk e di unë kam edhe një propozim konkret, po doja të bëja në lidhje edhe me propozimin që bëri zoti Kazaj. Kjo ka qenë besoj edhe në frymën e gjitha diskutimeve që ne edhe si Komision kemi bërë. Unë personalisht mendoj që përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës shtetërore, sipas këtij citimi përfshin: “çdo lloj përdorimi dhe të shtojmë një po themi vetëm njëren prej këtyre veprimtarive besoj që më shumë do t'i bënte dëm normës, se sa do të shëndoshte atë, për një arsyet tjetër sepse në qoftë se do rreshtojm vetëm një, mund të lëmë edhe të tjera, ndërkokë besoj që edhe Komisioneri e sqaroj”. Unë mendoj që përdorimi ka të bëjë si me pjesën fizike, si me pjesën teknologjike por edhe me pjesën mendore, ose atë intelektuale që të përdoret dhe punonjësi i administratës edhe pjesa e tij intelektuale mund të përdoret, pra nëqoftë se ne do t'i shtojmë pafund këto besoj që nësë do të shtojmë vetëm atë mund të harrojmë të tjera, unë mendoj kjo e përbledh, megjithatë është në vlerësimin e Komisionit. Për sa i përket nenit 3, unë do kisha një propozim konkret, nëse i referohemi pikës 1/1, ne kemi cituar që veprimitari të ndaluara për t'u promovuar janë veprimitari publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi dhe besoj që gjithë fryma e këtij akti apo Kodit Zgjedhor ka qenë pikërisht për të ndaluar veprimitari të caktuara të administratës në mënyrë të tillë që të mos bëhen publike, të mos

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*

*Dulaku*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Rregullator  
Dt.23.12.2020*

promovohen. Absolutisht që nuk është qëllimi i ligjit apo dhe këtij akti në tërësi që të pengojë veprimtarinë administrative normale të përditëshme të asnjë institucioni shtetëror. Kështu, në kushtet kur është vendosur një terminologji në këtë dispozitë mendoj që të bëhet një unifikim, duke qenë se është përdorur te kjo pikë termi veprimtari e ndaluar për t'u promovuar propozoj që e njëjta gjë të bëhet edhe në titullin e nenit dhe në pikën 1/3 të këtij nenit ku është përdorur terminologjia veprimtari të ndaluar, të shtohet edhe togfjalëshi për t'u promovuar.

**Znj.I.Nano:** Dakord, faleminderit z. Çaka!

**Znj.H.Vukaj:** Pasi dëgjova kolegun zotin Çaka me qëllim që mos të hamë kohën e publikut, por në të njëjtën kohë t'i japim mundësinë të elaborohet, por në të njëjtën kohë edhe të ecim do të doja që të dëgjonim Komisionerin se çfarë ka propozuar. Si propozuesi i këtij akti me titullin e këtij nenit ose të kësaj dispozite dhe se si e ka këndvështruar ai, apo se si i ka klasifikuar ai veprimet e ndaluara.

**Z.I.Celibashi:** Atëherë, me pak fjalë ndoshta dhe më shumë për qartësi të të gjithë të tjerëve të interesuar, veprimtaritë e ndaluara janë në rradhë të parë veprimtari publike dhe veprimtaritë publike, janë ato veprimtari që zhvillohen me praninë e publikut dhe të medias me prezencën e medias. Pra, nëse nuk janë këto dy kushte, prezenca e publikut dhe prezenca e medias nuk ka veprimtari publike, kjo e para dhe e dyta veprimtari të ndaluara publike, janë ato për të cilat institucionet shtetërore do t'i zhvillojnë në kushtet kur kanë alokuar dhe kanë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor, apo sipas planeve të tjera në periudhën katër mujore para datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve. Nuk e di nëse bëhej fjalë vetëm për këtë sqarim?

*Zbardhi materialin e incizuar  
Merita DULAKU*

*Dulaku*


*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

**Znj.H.Vukaj:** Po, për këtë sqarim për të kuptuar dhe publiku edhe në raport me çfarë përban norma, por edhe në të njëjtën kohë edhe me propozimin e kolegut tonë. Ideja është që nen me sa ne kemi kuptuar dhe lexuar këto ditë është një nen me një titull xhenerik. Pra, me sa ju shpjeguat përbledh të dy llojet e kategorive ose disa lloje kategorish, veprimtarish të cilat ose kryhen për të promovuar ose kryen për t'u bërë publike në prezencë të publikut. Kështu që, do të tha, diferencimi i kësaj fjale në titull do të përjashtonte kategorinë tjetër.

**Z.I.Celibashi:** Unë i qëndroj variantit të propozuar në lidhje me titullin dhe në përgjithësi me të gjithë projektaktin, po ndoshta gjatë diskutimit që ju si Rregulator do të bëni, por edhe kontributeve që mund të jalin përfaqësues të partive politike. Mundet që të rikonsideroj edhe pse nuk kam as një lloj të drejtë pas këtij momenti, pasi kjo është kompetenca juaj, por dua të them qartësisht dhe shkurt që titulli “veprimtari e ndaluar” e nenit përfshin çdo gjë që ka të bëjë me veprimtari e ndaluar në çdo lloj versionin, në çdo lloj kategorizimi të ndaluar – të promovuar, të ndaluar – të papromovuar edhe të tjera. Nuk mendoj se bën ndonjë dallim dhe sens titulli i nenit ashtu sikurse është përcaktuar veprimtari e ndaluar, i përfshin të gjitha kategoritë e veprimtarive publike të ndaluara. Si ato kur janë për t'u promovuar ashtu sikurse edhe nuk janë të promovuara, por në vehtvete përkufizohen si veprimtari të ndaluara.

**Znj.I.Nano:** Dakord, faleminderit. Për nenin tre, ka ndonjë propozim tjetër? Po zoti Çela pastaj zoti Çakaj.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

**Z.A.Çela:** Faleminderit Znj. Nano. Në nenin tre, 1.1, pika a, b, c, ç dhe d unë për veten time e gjej pa vend dhe pa sens ligjor fjalën “mbështetje” dhe propozoj që kjo fjalë të hiqet.

**Znj.I.Nano:** Pra, ju e keni fjalën veprimtarinë që përfshine mbështetjen dhe promovimin,

**Z.A.Çela:** Po vetëm fjalën mbështetje

**Znj.I.Nano:** Mbështetje dhe si togfjalë

**Z.A.Çela:** Po mbështetje dhe lidhëzën dhe.


**Znj.I.Nano:** Ok, z. Çakaj

**Z.M.Çakaj:** Po në neni tre, pas pikës tre, unë propozoj të shtohet një pikë me përbajtje, pra të shtohet pika katër.

**Znj.I.Nano:** Zoti Çakaj ndjesë, sepse më duhet t'i mbaj shënim me dorë të gjitha propozimet tuaj para se ti hedh për votim, sepse jemi në kushtet që e zhvillojmë online dhe jemi pa mbështetjen e administratës, për shkak të pandemisë jemi jo të gjithë në ambientet e KQZ-së.

**Z.I.Celibashi:** Vetëm për dijeninë tuaj dhe të gjithë të pranishmëve mbledhja regjistrohet, por edhe mbahet shënim, është një punonjëse e administratës që është duke i mbajtur shënim edhe pse nuk është me pamje, kështu që mos e kini merak.

*Zbardhi materialin e incizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

**Znj.I.Nano:** Dakord, ngaqë duhet vetëm në momentin që do të fillojmë të votojmë, do të duhet ta lexoj propozimin prandaj jam duke i mbajtur shënim.

**Z.I.Celibashi:** Edhe Sekretari i KQZ-së është prezent duke mbajtur shëним.

**Znj.I.Nano:** Dakord, faleminderit! Po zoti Çakaj

**Z.M.Çakaj:** Atëhere, pas pikës tre, të nenit tre, unë propozoj të shtohet pika katër me këtë përmbajtje: Katër muaj përpara datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve ndalohet dhënia e kontratave publike të koncesionit PIPIDI, për të cilat nuk është bëre njoftim publik se do të zhvillohen, nuk janë vijimi i një procedure koncesionare të nisur, apo nuk janë parashikuar për t'u financuar nëpërmjet buxhetit të miratuar të vitit zgjedhorë. Dhe më pas pika 5 dhe pika 6 të vijojnë dy pikat siç janë tani katër dhe pesë.

**Znj.I.Nano:** Pra, pas pikës tre, të shtohet pika katër, pra ju propozoni shtesë.


**Z.M.Çakaj:** Me përmbajtjen e sipërcituar dhe pikat e tjera të shtohen pesë dhe gjashtë.

**Znj.I.Nano:** Pra të kaloj pika pesë dhe pika gjashtë.

**Z.M.Çakaj:** Po të numërtohen me numrat pesë dhe gjashtë pikat e tjera.

**Znj.I.Nano:** Dakord, kemi propozime të tjera? Po, zonja Vukaj.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

**Znj.H.Vukaj:** Në lidhje me propozimin e bërë nga zoti Çakaj, është një propozim i konsoliduar i të dy neve, pra i z. Çakaj dhe i imi dhe në këtë kuadër jo vetëm e mbështes, por më duhet të sqarojë që është një garanci absolute e cila duhet t'i bashkëlidhet këtij akti dhe nuk duhet ti mungojë këtij akti, pasi në të kundërt akti do të dukej i mangët, formal dhe i pakuptimitë për qëllimin që do të arrijë. Në këto kushte janë konsistente te vlerat që ka dhe në të njëjtën kohë i kujtoj publikut që është një normë e dakordësuar politikisht më herët dhe e mbartur nga viti 2017. Kështu që, patjetër duhet të jetë pjesë e këtij akti. Faleminderit. Kurse përsa i përket sqarimit që bëri Komisioneri, e mbështesë në pjesën që ai sqaroi dhe çfarë i përbahet aktit dhe në momentin qe do të ketë diskutime në lidhje me propozimin që bënë dy kolegët para zotit Çakaj, atëherë po ndërhyj për të dhënë argumenta të tjera në lidhje me ato propozimin.


**Znj.I.Nano:** Dakoed, propozime të tjera nuk kemi për nenin tre, atëherë le të fillojmë diskutimet. Propozimi i parë, propozimi i zotit Kaziaj i cili propozoj që tek pika një një, e nenit tre, e cila sikundër germa ç, ndjesë jemi te 1/3, gërmë ç, zoti Kaziaj jam korekte 1/3, gërmë ç ?

**Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI:** Po

**Znj.I.Nano:** Propozoj që mbas fjalës brënda orarit të punës, rreshti dy, i gërmës ç, të shtohet “**edhe me mjetet e komunikimit elektronik**”. Jam korrekte në përcjelljen e propozimit tuaj?

**Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI:** Po! E nderuar Kryetare!

*Zbardhi materialin e incizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

**Znj.I.Nano:** Faleminderit!

**Znj.H.Vukaj:** Edhe me mjetet e komunikimit elektronik, por jo vetëm tha zoti Kaziaj me qëllim që mos të harroheshin edhe ato listimet.

**Znj.I.Nano:** Gjuhësish u diskutua nuk shkonin edhe me ato por jo vetëm, pra ideja ishte që të theksoheshin veçanërisht mjetet. Mund të jem unë gabim, zoti Kaziaj e formuloni edhe një herë propozimin tuaj?

**Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI:** Gjuhësish do ishte më korekte e riformular në këtë mënyrë: Jo të limituara vetëm me mjete e komunikimit elektronik ose domethënë dispozita është jo vetëm .. si mund ta përkufizojmë... edhe, më mirë ta lëmë, edhe që nënkupton dhe të gjitha mjetet të tjera qofshin këto dhe fizikisht në këtë rast.


**Znj.I.Nano:** Edhe me ...

**Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI:** Edhe me mjetet e komunikimit elektronik.

**Znj.I.Nano:** Dakord, kolegët diskutim për propozim e zotit Kaziaj përpara se ne ta votojmë. Po i nis propozimet sipas rradhës.

**Z.D.Çaka:** Unë ashtu siç e parashtrova dhe më parë, mendoj që do të jetë më e plotë kështu siç është dhe do të jetë më e cunguar nëse do shtohej vetëm ajo pjesë që zoti Kaziaj propozoi.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*  
*Komisioni Rregullator*  
*Dt.23.12.2020*

**Znj.I.Nano:** Në fakt është hera e parë që në mbledhjet e Komisionit Rregullator duke shqyrtuar një projektakt, kemi një propozim konkret për një shtesë, apo për ndryshim nga një përfaqësues i një partie politike, kështu që me këtë rast unë do të doja të shpreheshin nëse e vlerësonin edhe anëtarët e tjerë të Rregullatorit.

**Z.M.Çakaj:** Atëherë personalisht me riformulimin e duhur unë jam dakord me propozimin e zoti Kaziaj, nëse më lejon të bëjë një riformulim të këtij propozimi, “përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore, qendrore dhe vendore brenda orarit të punës, për veprimtari dhe ose aktivitete për qëllime zgjedhore edhe nëpërmjet mjeteve të informimit elektronik...”

**Znj.I.Nano:** Të komunikimit elektronik.

**Z.M.Çakaj:** Po të komunikimit elektronik, edhe nëpërmjet mjeteve

**Znj.I.Nano:** Edhe, edhe zhvendosjen, pas fjalës, për qëllime zgjedhore.

**Z.M.Çakaj:** po pas fjalës

**Znj.I.Nano:** Gjithsesi, duhet të marrim.

**Z.M.Çakaj:** Unë jam dakord me propozimin e zotit Kaziaj, pra ta riformuloj edhe një herë: përdorimin e detyruar në fushatë të administratës shtetërore, qendrore dhe vendore brenda orarit të punës, për veprimtari dhe ose për aktivitete për qëllime zgjedhore, edhe nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik, si dhe përdorimin

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

në mënyrë të detyruar". Në gjykimin tim personal, kësaj norme thjeshtë i kemi shtuar një mënyrë të detyruar, një mënyrë tjetër përdorimi, pra përdorimi i detyruar në fushatë i administratës shtetërore mund të kryhet ose nëpërmjet urdhërit verbal, ose nëpërmjet detyrimet me mjete elektronike dhe kjo është vlerë e shtuar, është një garanci më shumë, në funksion të moskeqpërdorimit të burimeve njerëzore në fushatë zgjedhore.


**Znj.I.Nano:** Zonja Vukaj për propozimin e zotit Kaziaj keni diçka?

**Znj.H.Vukaj:** Për sa kohë u shpreh si palë e interesuar, e shikon me vend është ai që e monitoron nga jashtë, apo njeh pikat e riskut si subjekt politik, mendoj që është dakord me draftin që sapo lexoi kolegu.

**Znj.I.Nano:** Në këtë moment, ndoshta për gabimin tim, unë e nisa nga propozimet dhe nga më i pari i zoti Kaziaj, po ndoshta votimin e nenit duhet ta nis nga fillimi i nenit, sepse kemi edhe propozime të tjera që në rradhën e shkrimit janë më herët, apo dëshironi të votojmë propozimin e zoti Kaziaj për germën ç? Unë personalisht do të isha duke theksuar se është hera e parë që kemi një propozim nga partitë politike, të kalojmë në propozim këtë votim dhe pastaj t'i rikthehem nga fillimi i nenit 1.

**Z.D.Çaka:** Unë jam dakord që të votojmë njëherë propozimin e zotit Kaziaj pastaj propozimet e tjera. Besoj që çdo lloj propozimi që kanë bërë edhe anëtarët e tjerë, nuk është se interferon me këtë pikë të nenit që ka propozuar zoti Kaziaj.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Rregulator  
Dt.23.12.2020*

**Znj.I.Nano:** Dakord, në këtë rast unë e nisa me diskutimin dhe më tej me votimin, sipas rradhës së bërjes së propozimeve. Mbasit të mbarojmë me propozimin e zotit Kaziaj do t'i rikthehem i nenit 1 nga e para, për të parë rradhën e propozimeve sipas mënyrës së të shkruarit në nen. Atëherë, propozimi i zotit Kaziaj që u mbështet dhe u shtua nga zoti Çakaj është për të shtuar shprehjen “edhe me mjetet e komunikimit elektronik”, në gjermën ç, të pikës 1 të nenit 3 të projektvendimit, shprehja “edhe me mjetet e komunikimit elektronik”, pas shprehjes për qëllime zgjedhore, në rreshtin e 3 të gjermës ç.

**Të nderuar kolegë kush është dakord me propozimin e Z. Kaziaj?**

**Pro:** 5 (zpj.Nano, z.A.Çela, z.D.Çaka, zpj.H.Vukaj, z.M.Çakaj)


**Kundra:** S'ka

Me pesë vota pro miratohet propozimi i z. Kaziaj,

Ju lutem administratës si kundër Komisioneri e tha të mbajë shënim vendin ku u shtua shprehja edhe me mjetet e komunikimit elektronik. Atëherë nëse më lejoni të nderuar kolegë po rikthehem në fillim të nenit tre, për të vlerësuar cilat janë propozimet e para, ose propozimet sipas rradhës në kuptimin jo kohor, por në kuptimin e renditjes. Atëherë kemi një propozim të zotit Çaka, për të ndryshuar ose për të shtuar një fjalë në titullin e nenit, pra atë që e kemi te pika ii, veprimtari të ndaluara për t'u promovuar, të shtohet në titull dhe të shtohet në 1/3, pra fjalë veprimtari të ndaluar të zëvëndësohet me fjalën veprimtari të ndaluar për t'u promovuar. Kolegë diskutimi për ju, para se ta votojmë, po zonja Vukaj.

**Znj.H.Vukaj:** Paraprakisht kam një parantezë dhe e gjej me vënd draftin e mbështesë draftimin që ka bërë Komisioneri, neni 3 (tre) e kemi kaluar më herët në shqyrtim prej disa ditësh dhe në propozim edhe të zotit Çaka, për ta diferencuar këtë kategori e cila i paraprin kësaj dispozite, kemi shtuar në pikën 1/1 brenda

*Zbardhi materialin e incizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

thonjzave nga “Veprimitari e ndaluar” “Veprimitari të ndaluar” për t’u promovuar, kështu që mendoj që është shteruese, për gjithë sqarimin dhe meraku që ka zoti Çaka, që kjo kategori duhet të jetë kategoria e veprimtarive të ndaluara për t’u promovuar, pjesën tjetër e sqaroi më së miri Komisioneri kështu që nuk mendoj që titulli duhet të mbetet xhenerik dhe jo të përfaqësojë vetëm një kategori.

**Znj.I.Nano:** Zonja Vukaj faleminderit! Kolegë të tjerë?

Hedhim në votim propozimin e zoti Çaka, por sipas radhës i bie një ndryshim në titull, së pari, titulli i nenit është “veprimitari të ndaluar” propozohet nga z. Çaka të bëhet “Veprimitari të ndaluar për t’u promovuar”.

**Pro:** 3 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka)

**Kundër:** 2 (znj.Vukaj, z.Çakaj)

Atëherë me tre voto pro me dy vota kundër, nuk miratohet propozimi i zotit Çaka. Për hir të procedurës, meqenëse në këtë nen, në këtë pikë pati ndërhyrje më duhet të hedh në votim titullin e nenit, siç është propozuar nga Komisioneri.


Kush është dakord.., me këtë rast edhe propozuesit dhe të mbështetësve do t’u bëja thirrje të mos bllokojnë.

**Z.D.Çaka:** Duhet të votohet që tani titullin e nenit? Më fal

**Znj.I.Nano:** Po fillojmë tani me titullin e nenit, që të vazhdojmë më poshtë, se nenin 2 e kemi miratuar, jemi te neni 3, dhe vetëm propozimi i zoti Kaziaj doli jashtë, jashtë radhe

**Z.D.Çaka:** Dakord, meqenësë jemi te propozimi i titullit, mund të shtoj diçka të lutem?

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

**Znj.I.Nano:** Po

**Z.D.Çaka:** Mëqenëse unë kisha një propozim konkret dhe nuk u gjet me vend që të pranohej nga Komisioni, unë pavarësisht se jam i mendimit që duhej të ishte shtuar pikërisht kjo pika, pra ai togfjalësh që unë propozova, paraprakisht domethënë edhe për ti dhënë rrugë miratimit të aktit, i cili ashtu siç theksova dhe më përpara është një akt i rëndësishëm, pavarsisht se do të doja të ishte një tjetër formulim, mbase këtij rrëzimi në parim, për të dyja ato pika që unë propozova dhe u rrëzuan, e shpreh që tani që unë do të votoj pro, besoj që e kisha këtë të drejtë që unë kisha një propozim konkret dhe nuk u miratua.

**Znj.I.Nano:** Dakord, meqenëse e theksoj edhe një herë, për të pasur...

**Z.D.Çaka:** Faleminderit!

**Znj.I.Nano:** Faleminderit zoti Çaka, atëherë e theksoj edhe një herë që kemi pasur një propozim për ndryshim të titullit dhe nuk u miratua, jam e detyruar të hedh në votim titullin siç është propozuar nga Komisioneri, titulli i nenit 3, veprimtari të ndaluara.


**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.A.Çela, z.D.Çaka, znj.H.Vukaj, z.M.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Do të vi momenti, që po përballemi ndoshta sot për herë të parë me gjith këto propozime me shtesa dhe ndryshime dhe kolegët duhet të... dhe pjesëmarrësit të na mirëkuptojnë. Atëherë, propozimi i radhës për këtë nen, ishte propozimi i zoti Çela

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Rregullator  
Dt.23.12.2020*

i cili propozoi që në pikën 1/1, germa a, b, c dhe ç, më falni pika a, b , c, ç edhe d të hiqej togfjalëshi “mbështetje dhe” hiqej mbështetje dhe nënkuptohet, bie lidhëza dhe për të lidhur me promovimi.

Zoti Çela doni ta argumentoni edhe një herë propozimin tuaj?


**Z.A.Çela:** Siç e thash dhe në fillim më duket pa sens ligjor është një ka një hapsirë shumë të madhe fjala mbështetje, është një oqean i madh, nëqoftëse dhe Komisioneri na i shpjegon, për mua nuk e di.

**Znj.H.Vukaj:** Unë sërisht personalisht për sa kohë ne ju përmajtëm aktit të Komisionerit dhe ecëm punuam mbi këtë draft besoj se Komisioneri e ka menduar më së miri sinkronizimin që gjijnë midis njëratjetrës, mbështetje dhe promovimi, ndaj ftoj edhe një herë që të na i sqarojë që të qartësojmë këtë pjesë në mënyrë që edhe kolegët të mos pengojmë ecjen e aktit. Faleminderit!

**Znj.I.Nano:** Zoti Çakaj, zoti Çaka, Komisioneri diçka për..

**Z.D.Çaka:** Po, unë jamë ashtu siç kemi bërë dhe diskutimet e mbështesë këtë propozim të zoti Çela, sepse me të vërtetë domethënë fjala mbështetje është një fjalë shumë e gjërë e cila mund të përfshijë shumë aspekte të fushës jetike dhe mendoj që i jep një pafundësi të interpretimeve, jo vetem, por mbase, Komisioneri jo mbase po jam i bindur, që Komisioneri e ka një interpretim lidhur me këtë po do të krijojë edhe një përshtjellim edhe te subjektet e tjera të cilat më shumë do ta zbatojnë këtë akt, sepse duhet patur parasysh është e vërtetë që i bëjmë aktet në mënyrë të tillë që mbase.. Duke qenë se Komisioneri e ka propozuar dhe kërkojmë edhe një herë mendimin e tij cili ka qenë qëllimi i propozuesit, por nuk duhet të

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*  
*Komisioneri Rregullator*  
*Dt.23.12.2020*

harrojmë që aktet në rradhë të parë të jenë në terminologjinë e tyre edhe më të kuptueshme dhe jo të krijojnë një përshtjellim, për ata të cilët do t'i zbatojnë. Në kushtet kur ky akt do të shqyrtohet nga një armatë e madhe e administratës, atëhere mendoj që kjo më shumë do të krijonte njëfarë komplementimi dhe diversiteti në punën e tyre dhe mbështetje mbështetje duke krijuar problematika edhe në raportimin e rasteve sipas detyrimeve të Kodit Zgjedhor dhe të këtij projektvendimi, që në rast se do të miratohet do të kthehet në një detyrim, kështu që unë mendoj dhe e mbështes propozimin e zotit Çela, faleminderit!


**Znj.I.Nano:** Dakord, faleminderit zoti Çaka nëse nuk ka, po Komisioneri, po kishte diçka?

**Z.I.Celibashi:** Po, një sqarim në lidhje me këtë formulim ideja është kjo që “Çdo veprimitari të ndaluar” ne kemi bërë dhe shtesën promovuar por ndoshta nuk ishte nevoja për të kundërshtuar kemi thënë që: Këto lloj veprimtarish të cilat janë të ndaluara sipas këtij akti edhe sipas Kodit Zgjedhor të ndryshuar, janë të ndaluara edhe për t'u mbështetur edhe për t'u promovuar. Pra nëse një veprimitari është e përkufizuar si e ndaluar është e cilësuar si e ndaluar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kjo veprimitari as nuk duhet të promovohet as nuk duhet mbështetur, kemi vënë mbështetjen si term...

**Znj.H.Vukaj:** Mjet garancie.

**Z.I.Celibashi:** Po, mbështetjen si term për të evituar çdo lloj kuptueshmërie, për çdo lloj në raste kur nuk është promovim që unë nuk po e promovon këtë projekt në kushte të ndaluara, por ndërkohë je duke e mbështetur.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*




*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*  
*Komisioneri Rregulator*  
*Dt.23.12.2020*

**Znj.I.Nano:** Dakord, kalojmë në votim, po zoti Çakaj

**Z.M.Çakaj:** Edhe një diçka të vogël, ashtu siç sapo besoj dha një sqarim shterues Komisioneri, që në titull ne po draftojmë një nen, i cili bënë fjalë për “Veprimitari të ndaluara”. Edhe në kuptim së pari, të Kodit Zgjedhor të nenit 91 dhe 92 dhe së dyti edhe të këtij akti që ne po miratojmë, sigurisht biem dakord të gjitha palët që: “Veprimitaritë e ndaluara” nuk lejohen as të promovohen, as të mbështeten dhe as të kryhet as një lloj veprimitarie me to, për arsyen e thjeshtë dhe të vetme se palët mund të marrin avantazhe apo privilegje të padrejta 4 (katër) muaj përpëra deri në datën e zgjedhjeve dhe në këtë kuptim nuk ka sens, që nga njëra anë ne të ndalojmë promovimin, pra mos ta reklamojmë atë, por nga ana tjetër ta financojmë atë projektin, apo atë veprimitarinë e ndaluar. Pra mua më shkojnë që të dyja që nëse ti ndalon promovimin e projekteve sigurisht nuk do ti japësh as mbështetjen qoftë financiare, qoftë mbështetje logjistike, qoftë mbështetje njerëzore atij projekti. Pra thjeshtë kjo kategori veprimitarie është e ndaluar dhe nuk lejohet në asnje formë, apo mënyrë, të mbështetet apo promovohet. Kështu që në këtë konteks unë i gjej të dyja fjalët, pra edhe mbështetje dhe promovim, i gjej të dyja në sinkron dhe në funksion të njëratjetrës dhe e gjithë gjëja është në funksion të ndalimit të veprimitarisë së ndaluar, pra mospromovimi, mos mbështetjes, frenimit të veprimitarisë së ndaluar për këtë periudhë kohore.

**Znj.I.Nano:** Po, faleminderit zoti Çakaj, para se të kalonim në votim kisha edhe unë një propozim të vogël, ndoshta saktësim mund të jetë, megjithatë çështje vlerësimi mund të jetë dhe votimit më tej të Komisionit. Te pika 1/3 të nenit, “Veprimitari të ndaluara” janë dhe ato veprimitari që përfshijnë dhe kemi pikën a:

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

shpérndarjen e veprimtaritave publike për periudhën 4 (mujore) nga data e zgjedhjeve, absolutisht që kam qenë që në diskutimet e para shumë dakord për ta kategorizuar të ndaluar këtë veprimtari, por për merak të publikut ose qytetarëve do të propozoa një shtesë, një përjashtim, gjithmonë jo për shpérndarjen publike, më ndihmoni.. përveç veprimtarisë normale në sportel, thënë me fjalë të tjera, nëse ju duket me vend.

**Znj.H.Vukaj:** Unë mendoj se e konfondon.


**Z.M.Çakaj:** Nuk shpérndahen lejet e legalizimit me kamera.

**Znj.I.Nano:** Jo nuk është vetëm kamera, është ajo që quhet pjesëmarrje publiku, le të themi që kemi 5, 7, 10 veta në sportel njëkohësisht përshebull, gjithmonë këta brenda institucionit ku shpérndahen lejet e legalizimit.

**Znj.H.Vukaj:** Kam përshtypjen se shpérndarja e këtyre titujve bëhet edhe nëpërmjet postës, kështu që do të gruponim një nga llojet e mënyrës së shpérndarjes. Mjafton që ta shterosh mediatikisht se çfarë presupozohet, nuk do të ndalohet si proces, por ndalohet eksposzimi i saj mediatik, trumbetimi i saj për hir të fushatës zgjedhore, apo përdorimit të fushatës.

**Znj.I.Nano:** Në disa raste ne projektakt, Komisioneri por edhe ne gjatë shqyrtimit jemi kujdesur që të vendosim disa përjashtime më tepër për të shuar merakun e qytetarit, të publikut dhe ky është një nga ato rastet, ky është një shërbim që i ofrohet publikut. Ne ndalojmë veprimtarinë publike.

*Zbardhi materialin e incizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*  
*Komisioni Rregulator*  
*Dt.23.12.2020*

**Z.M.Çakaj:** Zonja Nano më fal. Të ftoj ta rilexojmë edhe njëherë normën në 1.3 pika a, gërma a. Atëherë 1.“veprimtari të ndaluara”, janë edhe ato veprimtari që përfshijnë: a) shpërndarjen në veprimtari publike të lejeve të legalizimeve, në periudhën 4 mujore para datës së zgjedhjeve, që do të thotë që në veprimtari publike nuk do të thotë veprimtari, përditshmëri, rutinë dhe nga ana tjetër veprimtari publike e ke te neni 1 te përkufizimi, më fal neni 2 përkufizimet germa b jepet perkufizimi i veprimtarisë publike ku sqarohet se janë të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias në kuptim të nenit 1, të pikës 1 nenit 92 të Kodit Zgjedhor, te kryera nga subjektet..


**Znj.I.Nano:** Patjetër.

**Z.M.Çakaj:** Më fal ta mbaroj. Të kryera nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim dhe në këtë vendim subjektet e identikuara si persona që e kanë të ndaluar, e kemi të sankzionuar në mënyrë të qartë kush janë dhe në rastin konkret për lejen e legalizimit, veprimtaria normale funksionale e institucionit të ALUIZMIT që sot e ka marrë emrin ASHK, e kryen specialisti atje në sportel dhe në dijeninë time edhe për shkak të situatës apo pandemisë kjo veprimtari tani kryhet vetëm on-line. Bëhet aplikimi on-line dhe merret on-line gjithë..

**Znj.I.Nano:** Është alternative.

**Z.M.Çakaj:** Po mirë është alternative po nuk para ndodh që të ta japë drejtori i ASHK-së, të të japë lejen e legalizimit atje në sportel. Nuk para ndodh. Ta jep vetëm specialisti.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

**Znj.I.Nano:** Jo drejtori, nuk po flas për drejtorin, të lutem, të lutem!

**Z.M.Çakaj:** Specialisti e ka detyrë funksionale këtë.


**Znj.I.Nano:** Sigurisht, ja vetëm për merak këtë doja të shtoja në projektvendim gjithsesi kur ti vijë momenti e votojmë. Nuk po flas fare për drejtorin.

**Z.I.Celibashi:** A mund të jap një sqarim në lidhje me këtë?

**Znj.I.Nano:** Po

**Z.I.Celibashi:** Se ndoshta vlen ai meraku juaj zonja kryetare. Shpërndarja e lejeve të legalizimit nuk pengohet nga ky akt. Ajo ç'ka pengohet është shpërndarja e lejeve të legalizmit jashtë atyre procedurave që ka përcaktuar ligji për shperndarjen e lejes së legalizimit dhe ajo ç'ka është më e rëndësishme, shpërndarja e lejeve së legalizimit me pjesëmarrje të publikut ose të medias. Pra, shpërndarja në sportel sikurse edhe ju e sollët si rast nuk është shpërndarje e lejeve së legalizimit me pjesëmarrje të publikut pavarsisht numrit të personave të interesuar për të marrë lejen e legalizimit. Unë si propozues i këtij akti kuptoj shumë mirë që shpërndarja e lejeve të legalizimit në sportel, apo on-line apo nëpërmjet postës nuk karakterizohet si veprimtari e ndaluar dhe nëse ne te gjithë, pra dhe ju si Rregulator keni këtë kuptueshmëri mendoj që nuk do jetë nevoja se ne do jemi ata që do ta zbatojmë këtë aktin, që ta bëjmë këtë shtesën dhe këtë plotësimin. Të bëhet kjo shtesë dhe ky plotësim nga ana juaj. Pra, ndalimi është vetëm shpërndarja e lejeve të legalizmit në publik dhe me pjesëmarrje të medias. Çdo lloj mënyrë

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*  
*Komisioni Rregullator*  
*Dt.23.12.2020*

tjetër e shperndarjes së lejes legalizimit është në përputhje me ligjin dhe ky akt nuk e ndalon. Faleminderit!

**Znj.I.Nano:** Dakord Komisioner, faleminderit ju. Po zoti Çaka?

**Z.D.Çaka:** Jo, unë realisht, unë mendoj që jemi në të njëjtën vale, frekuencë të një nen, të një dispozite tjetër që u be nga zoti Kaziaj dhe unë e shtrova që në momentin që e përfshin nuk ka nevojë që të shtohet dhe diçka tjetër që mund të jetë e përfshirë dhe Komisioni me të drejtën e tij gjithsecili duke përfshirë edhe votën time pavarisht se unë e shpreha mendimin në arsyetimin që nuk isha shumë dakord, e pranoj dhe nuk ka asgjë të keqe kur ne e çelëm praktikën për të bërë një le të themi sqarim të mëtejshëm. Nuk ka asnjë gjë të keqe që ta sqarojmë këtë gjë. Pse? Sepse në fund të ditës është e njëjta vazhdimësi që unë them. Duhet të jemi shumë të kujdeshëm me ata njerëz të cilët nesër do ta lexojnë këtë akt dhe këtë akt do ta lexojnë edhe punonjësit e institucioneve shtetërore por, do ta lexojnë edhe qytetarët dhe mos krijojmë edhe situata edhe më kaotike në momente të caktuara. Nuk po them që edhe kjo është e tillë por një element sqarues unë mendoj që është i vlefshëm. Ose propozimi i zonjës Nano, pra që të përjashtohet shpërndarja normale në sportele që bëhet sot nëpërmjet Adisës ose duke shtuar edhe një togfjalësh tjetër me përjashtim të rasteve të përbushjes të veprimtarive funksionale të institucionit. Mbase të gjejmë një terminologji që të bëjmë një sqarim që nuk janë vetëm të bllokuara, të themi shpërndarja e lejeve të legalizimeve por njëkohësisht unë nuk e referoj vetëm te pika a), e njejtë gjë referohet dhe te pika b) përderisa kemi edhe certifikata pronësie apo çfarëdolloj titulli tjetër pronësie. Unë e mbështes propozimin e zonjës Nano dhe unë dhashë edhe një tjetër lloj formulimi dhe meqë mendoj që në mbledhjen e sotme mendoj

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioneri Rregullator*

*Dt.23.12.2020*

që ishte hera e parë që kemi pasur edhe diskutime, kemi pasur edhe kundërshtime për pika të caktuara të akteve, edhe votime kundër mbase edhe votim i parë që kur është krijuar ky Komision dhe shumë mirë pse jo. Kjo jo vetëm që do na bëjë mirë, por mund të rrisi edhe cilësinë e aktit kështu që unë them që nuk ka asgjë të keqe dhe pse ne e nisëm sot këtë proces me propozimin e zotit Kaziaj, kështu që ja mbështes propozimin zonjës Nano, faleminderit.

**Znj.I.Nano:** Dakord, atëherë unë mendoj që të kalojmë në votim. Kemi së pari propozimin e zotit Çela për të hequr fjalën “mbështetje”” në pikën 1.1 gërm a, b, c, ç dhe d.

**Znj.H.Vukaj:** Në fakt nuk na dha një argument shterues ligjor zoti Çela ku të na jepte një referim që ku ndalohet.

**Z.A.Çela:** S'më jep asnje sens ligjor prandaj e thashë.


**Znj.H.Vukaj:** Po pikërisht pra, ku referohesh ndërkohë që Komisioneri ishte i qartë.

**Znj.I.Nano:** Jo domosdoshmërisht do ta argumentojë pjesën. Është vlerësimi i propozuesit të ndryshimit konkret kështu që ne në çdo rast jemi të detyruar ta votojmë, pro ose kundër nuk ka... Atëherë më lejoni të kaloj në votim propozimin e zotit Çela për ndryshimet që ai propozoi, pra për heqjen e fjalës “mbështetjen” nga gërm a, b, c dhe ç pikë/1 e nenit 3 të projektvendimit.

**Kush është pro propozimit të zotit Çela?**

**Pro:** 3 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka)

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

**Kundër:** 2 (znj. Vukaj, z. Çakaj)

Atëherë 3 vota pro dhe 2 vota kundër propozimit të zotit Çela. Propozimi nuk miratohet për shkak se është nga ato akte ku votimi qoftë nen për nen qoftë në tërësi kërkon 4 vota pro. Zoti Çela në rastin sikundër thashë dhe në rastin Çaka do të vijë momenti që do të votojmë tekstin e propozuar nga Komisioneri dhe duke qenë që për këto pika të këtij neni, germa që ju keni propozuar dhe u rrëzua propozimi juaj, tashmë do të hidhet në votim varianti i Komisionerit. Keni ndonjë gjë paraprakisht zoti Çela nëse mundet një reflektim apo?

**Z.A.Çela:** Siç tha zoti Çaka, përderisa nuk pati mbështetje, do të pranoj propozimin që do të bëni ju dhe të shikoj se si do ta votoj.

**Znj.I.Nano:** Dakord, nuk do të kemi propozim të ri. Ne do të votojmë këtë pikë sipas tekstit të propozuar nga Komisioneri. Po besoj është pikërisht momenti për ta bërë këtë. Pra, titullin deri tanë kemi votuar veprimitari të ndaluara, në pikën 1, 1.1 me gërmat a, b, c, ç dhe d. I votojmë kështu gradualisht pikë mbas pike të nderuar kolegë?

**Z.D.Çaka:** Unë mendoj që të gjitha këto pikat, pikën 1.1 ta votojmë bllok.

**Znj.I.Nano:** Po pra pikën 1.1.


Atëherë, Unë gjithashtu reflektoj në kuadër të zhbllokimit të situatës për të mos dhënë votë kundër.

**Kush është dakord me pikën 1.1 sipas propozimit të Komisionerit?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka!

*Zbardhi materialin e incizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

Atëherë me 5 vota pro miratohet pika 1.1 e nenit 3 të projektvendimit. Atëherë për pikën 1.2 a kemi ndonjë propozim konkret megjithëse unë e kam bërë kërkesën për propozimin për nenin në tërësi. Për pikën 1.2 nuk kemi pasur propozime për shtesa apo ndryshime. Atëherë vimë te pika 1.2. Do ta kaloj në votim. Kolegë *kush është dakord me pikën 1.2 sipas tekstit të Komisionerit? Tekstit të propozuar nga Komisioneri?*

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka

Me 5 vota pro miratohet dhe pika 1/2 e projektvendimit. Kalojmë te pika 1/3. Në pikën 1/3 patëm propozimin e zotit Çaka. Zoti Çaka do të vijoni ta ruani propozimin tuaj se deri më tani rrëzuam vetëm titullin? Do të doni të votojmë edhe propozimin tuaj për veprimtari të ndaluara për t'u promovuar në fillim të pikës 1/3?

**Z.D.Çaka:** Unë mendoj që në momentin që e kam propozuar edhe këtu absolutisht që do t'i qëndroj propozimit tim. Sepse në kushtet ku votuam vetëm kreun, vetëm titullin proceduralisht duhet të votohet edhe ky propozim tjetër te kjo pikë që unë bëra.


**Znj.I.Nano:** Dakord, atëherë për këtë pikë kemi 2 propozime. Propozimi i zotit Çaka për të zëvëndësuar togfjalëshin “veprimtari të ndaluara” me togfjalëshin “veprimtari të ndaluara për t'u promovuar”.

**Pro:** 3 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka)

**Kundër:** 2 (znj.Vukaj, z.Çakaj)

Atëherë për këtë propozim kemi 3 vota pro Nano, Çaka, Çela dhe 2 vota kundër Vukaj, Çakaj. Nuk miratohet propozimi.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

Sikundër dhe në rastin e parë duhet të vijojë me votimin e tekstit sipas propozimit të Komisionerit.

**Z.D.Çaka:** Jo të lutem. Unë mendoj që në rradhë të parë edhe ju bëtë një propozim këtu që s'është hedhur në votim, në mos gaboj te pikë 1/3 të cilin edhe unë e bëra një ripropozim kështu që unë mendoj që pasi të shyrtohen të dy propozimet, më pas të shihet dhe në tërësi pika 1/3 që mos votojmë me pjesë.

**Znj.I.Nano:** Atëherë te pikë 1/3, gërmë a, unë kërkova të shtojmë “përveç veprimtarisë normale të institucionit në sportel”.

**Z.D.Çaka:** Ndërkohë unë dua që ta shtoja që të ishte dhe te pikë b meqënëse është e njëjta procedurë, pra ka të bëjë dhe me certifikatat dhe titujt e pronësisë pikë b e këtij neni.


**Znj.I.Nano:** Pra, edhe te pikë b ku bëhet fjalë për shpërndarjen veprimtari publike të akteve për regjistrimin e të tjera e të tjera do themi përveç?

**Z.D.Çaka:** Unë bëra këtë formulim, me përjashtim të rastit të përbushjes së detyrave funksionale nga institucioni, ose të veprimtarisë funksionale të institucionit më saktë.

**Znj.I.Nano:** Përbushjes së veprimtarisë...

**Z.D.Çaka:** Të institucionit.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

**Znj.I.Nano:** Dakord, kalojmë në votimin e pikës, më falni të germës a. Votohet propozimi që unë bëra para pak minutash. Kush është dakord me propozimin për shtesë në këtë pikë?

**Z.M.Çaka:** Zonja Nano të lutem, bëjë dhe njëherë propozimin, ose ta formulojë Tani, sepse, unë mendoj se sqarimi i Komisionerit ishte shterrues. Megjithatë dhe në gjykimin tim personal veprimitari publike janë qartazi të ndara nga veprimitaria normale e institucionit. Në se doni të votojmë propozimin tuaj bëjini të ndara qartazi.


**Znj.I.Nano:** Zoti Çakaj, veprimitaria publike është qartazi veprimitari normale e një institucionit, bëhet e ndaluara në disa kushte të caktuara...

**Z.M.Çaka:** Mos doni të thoni transparente? Se ideja është të qartësojmë konceptin? Nacionin transparencë në veprimtarinë publike...

**Znj.I.Nano:** Jo jo, nuk ka lidhje, veprimitari publike institucioni bën, ka bërë dhe do të bëjë. Kjo është pjesë e veprimtarisë së institucionit.

**Z.M.Çaka:** Nacioni i veprimtarisë publike që ka dhënë ky akt dhe Kodi Zgjedhor është i ndryshëm nga veprimitaria normale funksionale publike e institucionit e përditshme. Në se ju doni të ndajmë qartazi veprimtarinë e përditshme nga veprimtaritë e ndaluara publike, hajt t'i japim një riformulim, të mos tregohemi reflaktar dhe ta sqarojmë këtë pikë dhe të ecim më tej.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*




*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*  
*Komisioni Rregulator*  
*Dt.23.12.2020*

**Znj.H.Vukaj:** Një sqarim për ta lehtësuar dhe për ta kuptuar për publikun por dhe për të thënë që është e pnevojshme. Veprimtari të ndaluara janë edhe ato veprime që përfshijnë: a) shpërndarjen në veprimtari publike; pra është shteruese dhe shumë e qartë që lejet e legalizimit bëhen të tilla kur merren tam-tame, apo kur shpërndahen publikisht. Kjo nuk mund të konfondohet me veprimtarinë administrative që institicioni kryen në përditshmërinë e tij. Veprimtaria publike mund të quhet e tillë për shkak se institicioni është publik, është nocion i përgjithshëm, por veprimtaria që kryen ky institucion është administrative, të mos e harrojmë këtë pjesë. Unë nuk mendoj se ka konfondim. Në rast se ju mendoni se kjo përbën pikë esenciale risku dhe do të ketë një keqkuptim, që unë nuk e shoh, po ua përsëris, atëherë bëni një riformulim për këto dy pika dhe përashton veprimtarinë e përditëshme që kryejnë këto institacione, ose veprimtarinë administrative konkrete.

**Z.M.Çakaj:** Zonja Nano, një propozim, me shumë gjasë ne kemi dhe pika të tjera që do të hanë diskutime të gjata, që kanë nevojë përrahje mendimesh dhe ka gjasa që ky akt do të shtyhet në miratim. Në se ju e shihni të arësyeshme, por ndoshta dhe nga propozime që mund të vijnë nga ana ime, nga ana e zonjës Vukaj, mund të duhet pak më shumë kohë. Se të gjitha palët kemi mbi pesë ditë që po diskutojmë mbi draftin e projektaktit. Sigurisht që janë reflektuar të gjitha mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet. Ky akt është shumë i rëndësishëm për nga natyra e tij dhe duhet të pasqyrojë e të reflektojë gjithë shqetësimet e përcjella qoftë nga subjektit zgjedhore, qoftë nga administrata, qoftë nga organizatat e ndryshme, por edhe të adresojë rekomandimet e OSBE/ODIHR. Kështu që nëse nuk e gjejmë për momentin formulimin e nevojshëm, le të marrim kohën e duhur dhe t'i propozojmë

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

panelit një formulë që të ketë konsensusin e të gjithë anëtarëve të rregulatorit. Nuk e di nëse isha i qartë!

**Znj.I.Nano:** Absolutisht zoti Çakaj, unë do të vijoj më së pari aty ku e la zonja Vukaj, meraku im si anëtare e Komisionit Rregulator, si juriste por edhe si një prej atyre që ka punuar disa dite së bashku me të gjithë kolegët, personalisht këtë akt nuk e konfrontoj. Meraku im ishte ai që shpreha lidhur me qytetarët, se mos vallë ata keqkuptojnë se veprimtaria normale e tyre është e penguar, ... kuptohet që në kuadër të teknikës ka pak probleme, megjithatë unë këtë merak kam. Meqenëse jemi këtu i votojmë këto dy propozime dhe pastaj bashkohem me mendimin e zotit Çakaj se ky akt ka prodhuar diskutime! Jemi ende duke zhvilluar një të tillë mbas kaq ditësh dhe nëse do të kemi ndonjë ngecje unë e propozoj që tani që ta kapërcejjmë dhe i rikthehem i më vonë, në mënyrë që t'i japim vetes kohë për të ecur me tutje me ato çështje për të cilat do të gjejmë dakordësinë me njeri tjetrin. I nderuar Komisioner, në fakt ky është akti juaj, i ardhur me propozimin tuaj dhe uroj që unë dhe zoti Çakaj së pari të mos shkelim procedurat tona të miratuara me rregullore. Nuk e di nëse ju keni një vlerësim për këtë diskutim të tanishëm. Jo për propozimet e mia e të zotit Çakaj, por këto ndryshime konkrete.

**Z.I.Celibashi:** Unë mendoj se do të ishte plotësisht e shëndetshme edhe për procesin dhe për një lloj mirëbesimi të të gjitha palëve në lidhje me këtë projektakt nëse do të procedoni ashtu sikurse zoti Çakaj propozoi dhe ju ratë dakord. Është shumë e rëndësishme që të eksplorojmë të gjitha ato mënyra apo mekanizma e formulime të cilat i bashkojnë palët. Padyshim është një eksperiencë e re edhe në pikëpamje të hartimit të këtij projektakti dhe nn jemi dëshmitarë të faktit që Komisioneri propozoi një draft të parë; pastaj propozoi një draft të dytë dhe me pas

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioni Rregulator*

*Dt.23.12.2020*

reflektoi bazuar mbi ato propozime të ardhura nga palët. Kështu që, është plotësisht e dobishme dhe nuk ka asgjë të papranueshme, por është shumë e dobishme të ecim me këtë frymë. Është normale, mendoj unë dhe nuk ka asgjë hipokrite në këtë mes që të gjithë ne të bëjmë përpjekje për të gjetur zgjidhjen më të mirë sepse në thelb ne kemi të njëtin kuptim mbi gjënë. Natyra e formulimit të aktit nuk duhet të na ndajë për aspekte të ndryshme të këtij akti.

**Znj.I.Nano:** Faleminderit Komisioner! Unë do t'i ftoja kolegët ta shohim në këtë këndvështrim dhe do të doja që të gjithë së bashku të ngrihem i nivelin e asaj çfarë përfaqësojmë dhe kur them këtë e kam fjalën pikësëpari profesionalisht, duke respektuar veten dhe të gjithë kolegët e nderuar për kontributet e tyre profesionale gjatë gjithë jetës. Së dyti, për atë çfarë përfaqësojmë publikisht, pasi secili prej nesh është votuar prej 107 deputetësh në kuvendin e Shqipërisë. Meqenëse, parimisht më duket se ramë dakord unë propozoj që të kalojmë tek neni 4 pasi neni 3, meqenëse për të ka tre propozime, mendoj ta lëmë për më vonë! Si mendoni ju?! Apo dëshironi të vijojmë diskutimet me nenin 3, ...?!


**Z.M.Çakaj:** Unë jam dakord të kalojmë tek neni 4!

**Z.D.Çaka:** Unë kam një sugjerim që të vazhdojmë nen pas neni! Teknikisht jemi të detyruar ta miratojmë nenin pastaj në tërësi!

**Znj.I.Nano:** Patjetër qoftë nenin, qofte aktin na duhet ti kalojmë në tërësi, pasi të jenë ezauruar të gjitha votimet mbi propozimet.

**Z.M.Çakaj:** Akti votohet në tërësi, kështu e ka edhe rregullorja!

*Zbardhi materialin e incizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

**Z.D.Çaka:** Për këtë nen ka problem sepse duhet ta kalojmë me pika, ...

**Z.M.Çakaj:** Ajo çfarë po diskutoja unë më parë ishte që si pale ti japim kohe njërit-tjetrit që së pari të gjejmë një formulë të pranuar për të gjitha palët, që mbase nuk të vjen për momentin dhe së dyti, nëse meraku juaj është që të ndajmë qartësisht veprimtarinë publike si nocion dhe përkufizim të dhënë edhe në respekt të kodit zgjedhor, por edhe në respekt të këtij projektakti. Formulimi që dhatë ju nuk besoj se e arrin këtë qëllim, e them këtë në gjykimin tim personal, ... prandaj po ju ftoj që t'i japim vetes kohë dhe mundësi të gjejmë një formulim të përbashkët, pse jo të jetë edhe i qartë për publikun i cili do ta zbatojë këtë projektakt.


**Znj.H.Vukaj:** Në fakt, publiku është ai që e pret, ... aktin e zbatojnë institucionet dhe administrata e përfshirë në to. Kështu që le të ecim me nenin vijues dhe ndërkohë kolegët propozues të mendojnë edhe një formulim tjetër, ...

**Z.M.Çakaj:** Ose edhe Komisioneri mund ta bëjë këtë, meqenëse e ka tagër nga Kodi Zgjedhor!

**Znj.H.Vukaj:** Patjetër edhe Komisioneri nëse e sheh të arsyeshme të përpunojë një draft tjetër. Na jep kohë edhe ne që tek ky nen të reflektojmë.

**Z.I.Celabashi:** Ky është një moment për të reflektuar, ... dhe si Komisioneri, apo dhe administrata të prezantojnë ato formulime që gëzojnë një konsensus sa më të madh, si të anëtarëve të Rregulatorit por edhe të palëve të interesuara në proces.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

**Znj.I.Nano:** Në fakt kemi pesë propozime për këtë nen, kështu që unë si kryetare propozoj të kalojmë me diskutime tek neni 4, t'i japim pak kohë vetes për të riformular propozimet edhe një herë, ndoshta edhe komisioneri me administratën mund të na mbështesin me një propozim të ri, ...

**Znj.H.Vukaj:** Ndërkokë edhe për të vlerësuar propozimet e dhëna!

**Znj.I.Nano:** Patjetër, për ti vlerësuar para se ti votojmë.

**Z.D.Çaka:** Dakord, kalojmë tek pika 4 atëherë!

**Znj.I.Nano:** Tek neni 4! Neni 3, edhe pse ishte një nen voluminoz, ishte neni që kishte më shumë propozime për shtesa dhe ndryshime!

**Paneli:** Dakord njëzëri për kalimin tek neni 4.

**Znj.I.Nano:** Në nenin 3 kemi vetëm një propozim të miratuar që është ai i zotit Kaziaj! Kemi edhe propozime të rrëzuara! Por kemi edhe propozime të tjera që ende nuk janë votuar!

**Znj.H.Vukaj:** Zonja Nano, të bëj një ndërhyrje të vogël të lutem!

**Znj.I.Nano:** Po patjetër zonja Vukaj!

**Znj.H.Vukaj:** Të krijojmë më shumë “ekonomi” për të gjithë ata që na ndjekin se ndoshta nuk jemi i vetmi fokus, por edhe për ne, në të njëjtën kohë, nuk është mirë

*Zbardhi materialin e incizuar  
Merita DULAKU*

*Dulaku*

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*  
*Komisioneri Rregulator*  
*Dt.23.12.2020*

që të kthehem i aty ku e lamë, ... Meqenëse në paraprakisht i kemi shqyrtauar dhe kemi rënë dakord për përbajtjen e ardhur nga Komisioneri, do të propozoj që në këto nene vijuese, ku në nuk kemi debat ose nuk kemi çfarë të shtojmë ose ndryshojmë t'i kalonim ashtu siç kemi bërë të gjitha herët me leximin e titullit të nenit.

**Z.D.Çaka:** Në parim unë jam dakord me këtë, por në këtë rast mbase është momenti për ta lexuar edhe për një arsyet të thjeshtë. Vetë zoti Kazaj që në fillim ngriti një pretendim që ka ardhur akti pak me vonesë dhe nga leximi i dispozitës besoj bëri edhe ndërhyrjen e tij dhe më pas u votua edhe nga komisioni, ... kështu që e di se është pak vonë, në terma kohore, na krijon lehtësi mos leximi i nenit, por unë edhe për t'i dhënë rëndësi, ... por mbi të gjitha për transparencën që edhe palët të mos thonë që nuk u diskutua. Unë jam i mendimit që ta lexojmë nenin por edhe t'i japim pak më shumë ritëm, ... edhe këtu jam dakord.


**Znj.I.Nano:** Po, gjithashtu do të përpinqem unë që t'i japim pak më tepër ritëm; si dhe kush të këtë propozime, njëherazi do të kërkonim ritëm nga të gjithë. Unë po vazhdoj me nenin 4, kreu III, ndërfaqja e raportimeve dhe administrimi i saj; procedura dhe afatet e raportimit

Pika 1.

Ndërfaqja e raportimeve përfaqëson faqen zyrtare të internetit të zotëruar dhe në shërbim të Komisionit Qendoror të Zgjedhjeve dhe të institucioneve të tjera për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësive ligjore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në këtë vendim. Ndërfaqja krijohet, administrohet dhe përditësohet nën autoritetin dhe përgjegjësinë e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Pika 2.

*Zbardhi materialin e incizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioni Rregulator*

*Dt.23.12.2020*

Informacioni që përmban ndërfaqja është i administrueshëm lirisht nga publiku i gjerë në momentin e hedhjes së të dhënave deri në datën e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

Pika 3.

Struktura përkatëse e teknologjisë së informacionit në KQZ mundëson akses të personalizuar për të gjitha subjektet e përcaktuara në pikën 2, neni 3 të këtij vendimi, me qëllim që të hedhim të dhënat për institucionin që organizon veprimtarinë, datën dhe orën e veprimtarisë, tematikën e veprimtarisë, nivelin më të lartë të pjesëmarrjes, të ftuarit e nderit, folësit e planifikuar dhe mediatizimin e veprimtarisë.


Pika 4.

Raportimi në ndërfaqe duhet të kryhet jo më vonë së pesë ditë para afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë ose të aktivitetit publik. Raportimi në ndërfaqe, në emër dhe për llogari të subjekteve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 3 të këtij vendimi, bëhet nga sekretarët e përgjithshëm të institucioneve publike dhe vendore, monokratike apo kolegiale; drejtorët e përgjithshëm apo drejtuesit më të lartë administrativë për agjencitë dhe institucionet nën varësinë e kryeministratit; drejtuesit ekzekutive të shoqërive tregtare në të cilat shteti ka pjesëmarrje në kapitale, kuota apo aksione më shumë së 50% të aksioneve; drejtuesit ekzekutive të ndërmarrjeve shtetërore e të enteve publike si dhe administratoret e njësive administrative.

Pika 5.

Subjektet sipas pikës 4 të këtij neni, kur e kanë të pamundur teknikisht të aksesojnë ndërfaqen, mund ta dërgojnë raportimin nëpërmjet e-mail-it zyrtar në adresën raportime.institucione@cec.gov.al ose nëpërmjet shërbimit të shpejtë postar. Momenti i aksesit në ndërfaqe, momenti i dërgimit të e-mail-it, ose momenti i

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

mbërritjes së postës në zyrat e komisionerit, përbën momentin kohor në të cilin fillojnë të ecin afatet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për shqyrtimin e raportimit sipas këtij vendimi.

Pra, të nderuar kolegë, ky ishte nen 4 lidhur me ndërfaqen, kemi edhe një nen tjetër lidhur me ndërfaqen, për atë së çfarë përfaqëson ndërfaqja, kush raporton në të, etj.

Atëherë çelim diskutimin për nenin 4; përfaqësuesit e partive politike, komente?!

Nuk shoh të kemi komente nga përfaqësuesit e partive politike. Kolegët e Komisionit Rregulator për nenin 4?! Atëherë nuk kemi propozime për shtesa apo ndryshime në nenin 4, kështu që ftoj kolegët të votojmë nenin 4 me përbajtje sipas propozimeve të ardhura nga komisioneri.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj. Nano, z. Cela, z. Çaka, znj. Vukaj, z. Çakaj)

**Kundër:** S'ka

Me 5 vota pro miratohet nen 4 i projektvendimit.


Kalojmë në **nenin 5**, me titull “Hapësirat dhe elementet e ndërfaqes së raportimeve”.

Pika 1.

Infrastruktura *hardware* dhe *software* për ndërfaqen e raportimeve ngrihet dhe instalohet në një server që administrohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Të dhënat e ndërfaqes ruhen në bazën e të dhënave të këtij serveri, që shërben për ruajtjen e përhershme të të dhënave. Regjistrimi, përpunimi, përdorimi, publikimi, siguria dhe ruajtja e të dhënave e informacionit në të kryhen nëpërmjet një sistemi të informatizuar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Pika 2.

*Zbardhi materialin e incizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

Ndërfaqja e raportimeve përfshin hapësirën publike, në të cilën kanë akses të pakufizuar të gjithë të interesuarit dhe publiku i gjerë dhe hapësirën e rezervuar, në të cilën aksesi sigurohet përmes identifikimit të përdoruesit me anë të të dhënave individuale.

Pika 3.

Hapësira publike e ndërfaqes duhet të sigurojë lehtësi dhe qartësi përdorimi, me përbajtje informuese të përditësuar dhe që është e lehtë për t'u aksesuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Pika 4.

Hapësira e rezervuar e ndërfaqes përbën tërësinë e aplikacioneve, të elementeve dhe të mundësive të cilat janë pjesë integrale dhe përdorimi i të cilave është i kufizuar për përdoruesit e autorizuar dhe të identifikuar sipas këtij vendimi dhe që shërben për të vendosur në ndërfaqe kërkesën e institucionit dhe të dhënat e tjera sipas këtij vendimi.

Pika 5.

Paraqitura grafike, funksionimi dhe përdorimi konkret i elementeve dhe i formave elektronike të parashikuara në këto rregulla, përcaktohen dhe realizohen nën autoritetin e Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve.

Është momenti për shtesa, komente, ndryshime apo propozime, më së pari nga ana e partive politike?! Me sa duket nuk kemi të tilla.


Nga ana e anëtarëve të Komisionit Rregulator, nëse ka të tilla?! Edhe këtu nuk kemi! Atëherë ftoj koleget të votojmë nenin sipas propozimit të ardhur nga komisioneri.

**Kush është pro për nenin 5 të projekt vendimit?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka!

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*  
*Komisioni Rregullator*  
*Dt.23.12.2020*

Me 5 vota pro miratohet nen 5 i projektvendimit.

Kalojmë tek **Kreu IV** me titull: Përdorimi i burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para dhe gjatë fushatës zgjedhore.

**Neni 6.**

Të drejtat dhe detyrimet e punonjësit të administratës shtetërore.

Edhe ky nen ka 7 pika dhe është gjithashtu shumë i rëndësishëm.

Pika 1.

Punonjësit të administratës shtetërore, gjatë periudhës zgjedhore, i krijojn kushtet e nevojshme dhe i garantojn moscënimi i të drejtave dhe lirive kushtetuese për të ushtruar lirinë e shprehjes dhe/ose për të marrë pjesë në veprimtari politike, brenda kufizimeve dhe ndalimeve, të përcaktuara me dispozita të veçanta të legjislacionit në fuqi dhe në këtë vendim.


Pika 2.

Punonjësi i administratës shtetërore i cili është regjistruar si kandidat për zgjedhjet pezullohet nga detyra nga momenti i rregjistrimit të tij si kandidat deri në datën e përfundimit të numërimit të votave në zonën ku kandidon. Për nепunësit, marrëdhënia e punës të të cilëve rregullohet nga Kodi i Punës, në rastet kur nuk njoftojnë për kandidimin, merret masa e ndërprerjes së marrëdhënieς së punës.

Pika 3.

Punonjësit të administratës shtetërore, gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda mjediseve të institucioneve shtetërore, i ndalohet çdo lloj pjesëmarrje në veprimtari me karakter politik, apo në funksion të politikës partiake, apo kandudatëve, apo në fushatë zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje. Punonjësit të administratës shtetërore i ndalohet të përdorë të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare, materiale njerëzore publike, me qëllim favorizimin e një partie politike, koalicioni, ose kandidati në zgjedhje.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Rregulator  
Dt.23.12.2020*

Pika 4.

Punonjësi i administratës shtetërore, vetëm pas orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucioneve shtetërore, ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike apo zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje.

Pika 5.

Gajtë pjesëmarrjes në veprimtari publike, apo zgjedhore, nëpunësit civil i ndalohet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike dhe të bëjë fushatë për një subjekt zgjedhor apo kandidat.

Pika 6.

Ndalohet përdorimi i detyruar në një fushatë zgjedhore i administratës shtetërore të institucionit, nëpërmjet ushtrimit të presionit ndaj tyre për këtë qellim, si dhe premtimit ose ofrimit te përfitimeve për nëpunësit publik për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës.

Pika 7.


Punonjësi i administratës shtetërore ka të drejtë të angazhohet si komisioner në përbërje të KAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve, pasi të ketë njoftuar paraprakisht eprorin direkt dhe njësinë e personelit për këtë veprimtari. Angazhimi si komisioner nuk duhet të ndikojë në përmbushjen e detyrave funksionale në përmbushje të etikës në administratën publike.

Kemi ndonjë propozim konkret nga përfaqësues të partive politike, ju lutem?! Nuk kemi!

Atëherë nga anëtarët e Komisionit, nëse ka ndonjë propozim konkret për këtë nen?!

Atëherë edhe për nenin 6 nuk kemi propozime për shtesa apo ndryshime nga asnjë nga të pranishmit në takim. Kështu që më lejoni të kalojmë në votimin e këtij nenii sipas përbajtjes së propozuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*


*Komisioni Rregullator*

*Dt.23.12.2020*

**Z.A.Kazaj, përfaqësues i LSI:** Zonja Nano, nëse mundem për një ndërhyrje. (Me falni edhe për vonesën); Në pikën 5 thuhet “Gjatë pjesëmarrjes në veprimtari apo aktivitete zgjedhore nëpunësit civile, ...” tani kemi nëpunës civile, kemi edhe persona përfaqësues shtetërorë me kontratë pune, të cilët nuk janë nëpunës civile. Do të duhet sipas meje një qartësim i kësaj pjese, pra përfshirjes edhe të ndërmarrjeve shtetërore të zotëruara nga shteti, me 50% e sipër, në mënyrë që të mos limitohemi vetëm tek nëpunësit civilë me këtë ndalesë, le të themi.

**Znj.I.Nano:** Më lejo, zoti Kazaj, të jap unë në fillim një shpjegim dhe më pas secili ka të drejtën të thotë mendimin e tij. Është një nen që i është nënshtuar debateve si të gjitha nenet, dhe ne, të prirur për të marrë maksimumin, thënë me fjalë të tjera, brenda ligjit, për të kufizuar sa më tepër shkeljet dhe pjesëmarrjet e administratës në veprimtari me karakter politik, gjatë shqyrtimit të këtij nenit dëshira e disa propozimeve rreth këtij nenit, kemi pasur parasysh së pari faktin që e drejta e shprehjes dhe me këtë rast, shprehjes së bindjeve politike, është e drejtë kushtetuese. Gjithashtu kemi pasur parasysh faktin që kushtetuta parashikon që kufizimi i çdo të drejtë të parashikuar në të bëhet vetëm me ligj dhe kemi parasysh që Ligji i Nëpunësit Civil në ninë 37 përmban pikërisht këtë kufizim. Madje ka disa kufizime më të rrepta për nëpunësit e kategorive të larta drejtuese, por meqë mbetemi vetëm tek pjesëmarrja ose shprehja e bindjeve apo preferencave politike, është fiks sikundër ligji i nëpunësit civil e parashikon, është e parashikuar në pikën 5 të këtij vendimi. Sa i përket shqetësimit tuaj lidhur me punonjësit e tjerë, por gjithmonë flasim për shprehje të bindjeve dhe preferencave, sepse pjesëmarrjen në veprimtari nuk e ndalon kush, ne kemi pasur diskutime të gjera si me legjislacionin vendas por edhe atë të huaj, qoftë kushtetutën, aktet ligjore e nënligjore, qoftë edhe

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

konventën evropianë të të drejtave të njeriut, qoftë edhe jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut. Në fakt nuk kemi gjetur vend ku të mbështetemi për të parashikuar kufizime në funksion të një të drejte kushtetuese. Nëse ju do të keni një propozim konkret, e mirëpresim, por mundësisht duke na ofruar një mbështetje ligjore të fuqishme për këtë gjë dhe të pa kontestueshme.

**Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI:** Zonja Nano, ju keni fiksuar pjesën e togfjalëshit “nëpunës civil” me qasjen që ligji për nëpunësin civil i bën këtij argumenti, duke thënë që në nivel kushtetues është një e drejtë kushtetuese, por ndërkohë një ligj që është në hierarkinë e normave më i ulët së Kushtetuta, ia ndalon këtë veprimtari një punonjësi. Pse Kodi i Punës nuk mund të merret si analogji në këtë rast po themi, duke qenë së flitet për punonjës shtetërorë dhe objekti kryesor përtej këtij akti është rregullimi i raportimit dhe monitorimit të veprimtarive të nëpunësve dhe të punonjësve shtetërorë.

**Znj.I.Nano:** Marrëdhënia e punës e të cilëve rregullohet me Kodin e Punës?!

**Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI:** Ekzakt!

**Znj.I.Nano:** Patjetër!

**Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI:** ... dhe janë taksapagues, le të themi, ... pavarësisht së bëjnë pjesë në shoqëri tregtare, ... që në fund të fundit kanë për qellim fitimin; por punonjësit që janë atje janë punonjës shtetërorë; janë nën administrim të shtetit.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*

*Dulaku*

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

**Znj.I.Nano:** Madje jo vetëm në ndërmarrjet shtetërore por edhe në KQZ ka nëpunës civile dhe punonjës administrativë me kohë të plotë, që trajtohen me kod pune. Pra, nisur nga përcaktimi kushtetues i nenit 17 ku kufizohet e drejta, në gjetëm vetëm kufizimin për nëpunësin civil. Jemi konsultuar edhe me Kodin e Punës dhe nuk kemi gjetur ku të mbështetemi për të vënë ato lloj kufizimesh edhe për punonjësit e tjerë jashtë shërbimit civil. Ndoshta fola në emër të komisionerit, në fakt ai është propozuesi, por sikundër e kemi thënë disa herë gjatë kësaj mbledhje publike, për variantin e dytë ne kemi punuar të gjithë në grup, le të themi kështu.

**Z.I.Celibashi:** Po qëndron i njëjti arsyetim. Pra ne e kemi bërë këtë dallim sepse e ka bërë Kushtetuta, e ka bërë ligji për nëpunësin civil dhe për të gjithë pjesën tjetër të administratës. Për aq sa i takon kufizimeve që duhet t'i imponojmë nëpunësit civil, ne i kemi qëndruar në mënyrë të përpiktë përcaktimeve ligjore. Për pjesën tjetër të administratës publike, që nuk janë nëpunës civile, në akt ka edhe për ata ndalime dhe kufizime pér mospërdorimin e tyre pér qëllime zgjedhore. Por duhet të themi që pér fat të mirë apo të keq, vetëm ligji pér nëpunësin civil ka vendosur angazhime apo kufizime të plota pér përfshirjen e tyre në veprimitari politike apo elektorale.


**Znj.I.Nano:** Dakord, nëse nuk kemi nga përfaqësuesit e partive të tjera politike dhe nëse edhe anëtarët e Rregulatorit nuk kanë komente pér nenin 6, do t'u ftoja kolegë të nderuar të votojmë nenin 6 sipas propozimit të komisionerit.

**Kush është dakord me nenin 6 ju lutem?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka!

*Zbardhi materialin e incizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*  
*Komisioni Rregullator*  
*Dt.23.12.2020*

Me pesë vota pro miratohet neni 6 i projektvendimit.


Atëherë kalojmë tek **neni 7** i projektvendimit me titull detyrat e sekretarëve të përgjithshëm dhe drejtuesve të institucioneve publike të pavarura e të varësisë.

Pika 1

Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve publike qendrore dhe vendore, të pavarura e të varësisë, kryetarët e bashkive, prefektët e njësive administrative dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë:

- a) organizojnë menjëherë punën dhe të marrin masat e nevojshme për garantimin e zbatimit të detyrimeve ligjore, për ndalimin e vëties në përdorim për subjektet zgjedhore të veprimtarisë së tyre institucionale, mjeteve, fondeve e materialeve të ndryshme, pronë e institucioneve shtetërore publike, si dhe të burimeve njerëzore të institucioneve të administratës shtetërore, në nivel qendror dhe vendor.
- b) të kontrollojnë në mënyrë periodike veprimtarinë e nepunësve dhe punonjësve nën varësinë e tyre, me qëllim shhangjen dhe parandalimin e nxitjes apo kërkesës për përfshirjen e punonjësve të administratës shtetërore në veprimtari politike apo në mbështetje të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje.
- c) publikojnë të dhënat e tyre të kontaktit në faqen zyrtare përkatëse të internetit, me qëllim administrimin e çdo denoncimin e çdo rasti të përfshirjes ose nxitjes apo kërkesës për përfshirjen e punonjësve të atij institicioni në veprimtari politike apo në mbështetje të një subjekti zgjedhor apo një kandidati në zgjedhje.
- ç) verifikojnë dhe analizojnë të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me përdorimin e mjeteve, fondeve e materialeve të ndryshme, si dhe mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë institucionale, gjatë periudhës përpëra fillimit dhe gjatë fushatës zgjedhore, në funksion të evidentimit të përdorimit ose jo të tyre për qëllime elektorale dhe marrin masa për denoncimin sipas rastit në KQZ, apo në prokurori.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioni Rregulator*

*Dt.23.12.2020*

d) marrin masat që automjetet si dhe karburanti, në përdorim të titullarit apo institucionit, të ndalohen të përdoren për veprimitari politike të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore ose të kandidatëve në zgjedhje, duke urdhëruar parkimin e detyruar të automjeteve në përfundim të orarit të punës, në ambjentet respektive të institucioneve. Bën përjashtim nga ky ndalim përdorimi i automjeteve të dedikuara zyrtarëve të lartë, Shërbimit të Protokollit të Shtetit, Gardës së Republikës atyre në shërbim të Policisë së Shtetit, në përm bushje të detyrave të tyre funksionale si dhe rastet e urdhëruara me autorizim për shërbime pune.

dh) marrin masa për ndalimin e iniciativave elektorale ndikuese dhe urdhëruese, apo të propagandës politike në funksion të fushatës zgjedhore në institucionet publike përkatëse.

e)marrin masa dhe monitorojnë zbatimin e tyre për të penguar keqpërdorimin dhe garantuar mospërdorimin e;

i.burimeve njerëzore të institucionit në funksion të veprimitarisë elektorale të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore, në zbatim të nenit 14, të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;

ii.fondeve të institucioneve për periudhën katër muaj përpala deri në datën e zgjedhjeve në funksion të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore;


iii.mjeteve dhe materialeve në inventar të institucionit për për periudhën katër muaj para deri në datën e zgjedhjeve në funksion të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore;

iv.institucioneve publike për zhvillimin e fushatës zgjedhore apo realizimin e propagandës politike në to;

v.veprimitarisë shtetërore për të favorizuar subjekte të caktuara zgjedhore;

Gjithashtu edhe ky nen, të nderur kolegë dhe të nderuar pjesëmarrës, ishte një nen i gjatë ku janë listuar detyrime të titullarëve të institucioneve, drejtuesve,

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

sekretarëve të përgjithshëm; ndoshta më mirëkuptojnë kolegët, kam një propozim për ndërrim vendesh të sekretarit të përgjithshëm me drejtues të institucionit për shkak të hierarkisë apo nëse dikush nga administrata që e ka punuar tekstin, mund të thotë diçka.

**Z.M.Çakaj:** Në fakt kam përshtypjen së radha e përcaktimit të personave është vendosur sipas radhës së raportimit, pra sekretar i përgjithshëm dhe me pas drejtues i institucionit dhe kështu duhet të jetë.

**Znj.I.Nano:** Po e kuptova.


**Znj.H.Vukaj:** Në ato institucione që nuk ka sekretar të përgjithshëm roli i raportuesit automatikisht i mbetet drejtuesit.

**Znj.I.Nano:** Ka ndonjë propozim konkret për ndryshime apo shtesa, së pari nga partitë politike. Nuk shoh të ketë. Po zoti Kaziaj urdhëroni.

**Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI:** Këtu flasim për detyra të përcaktuara të zyrtarëve të parashikuara në pikën 1 dhe formulohet përbajtja nga germa a) e vijim, ... a do të ishte më mirë që të parashikohen edhe afate së kur duhet të vihen në lëvizje këta persona për të marrë masa në përputhje me parashikimet e këtij nenit?

**Z.M.Çakaj:** A mund të jap unë një përgjigje. Zoti Kaziaj, këtu bëhet fjalë që personat e ngarkuar për raportimin apo titullarët e institucioneve nuk është se e kanë të përcaktuar agjendën, vetëm nëse ata do të kryejnë veprimtari që nga Kodi Zgjedhor dhe nga ky vendim do të konsiderohet e ndaluar. Pra kjo do të shihet rast

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

pas rasti; në fakt veprimitaria normale e çdo institucioni do të vazhdojë të funksionojë siç ka funksionuar. Vetëm ato veprimitari të cilat kanë karakter publik apo kanë karakter të ndaluar në respekt të këtij vendimi, do të duhet të raportohen. Besoj jemi të qartë në këtë pikë.

**Z.D.Çaka:** Jam plotësisht dakord me arsyetimin që bëri zoti Çakaj. Për më tepër, të gjithë këtyre funksionarëve afati iu fillon në datën 25 pra, 4 muaj para zgjedhjeve. Mund të ketë detyra të tyre që nuk janë të lidhura me një afat të përcaktuar por janë të përditshme, në vazhdimësi.

**Z.A.Kazaj, përfaqësues i LSI:** Më shumë e lidha me pikën e deklarimit të dhënave në faqen e internetit. Pra kur do të duhet ta ndërmarrin këta zyrtarë shtetërorë këtë hap? Kjo është!

**Z.M.Çakaj:** Nga data 26 dhjetor! Kjo faqe që në datën 26 duhet të jetë e disponueshme.

**Z.D.Çaka:** Nga e nesërmja! Bëhet fjalë për veprimitari që fillojnë që të nesërmen.

**Z.A.Kazaj, përfaqësues i LSI:** Dakord!


**Znj.I.Nano:** Dakord! A ka propozime, diskutime apo komente të tjera për nenin 7 ju lutem?!

Nëse jo, atëherë kalojmë në votim të nderuar kolegë!

Kush është dakord me nenin 7 sipas propozimeve të komisionerit, ju lutem?

**Pro:** 5 (z.nj.Nano, z.Çela, z.Çaka, z.nj.Vukaj, z.Çakaj)

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Rregulator  
Dt.23.12.2020*

**Kundër:** *S'ka!*

Me pesë vota pro miratohet neni 7 i projektvendimit.

Atëherë kalojmë tek **neni 8**.

Detyrat e Komisionerit për shkeljet e konstatuara dhe të raportuara gjatë fushatës zgjedhore. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në rastet kur kryesisht ose me informacion të paraqitur nga të tretët konstaton shkelje të detyrimeve të përcaktuara në këtë projektvendim paralajmëron me shkrim partinë politike, subjektin zgjedhor, apo kandidatin në favor të të cilit është kryer veprimitaria e punonjësit, njëherazi duke i kërkuar edhe ndërprerjen e kësaj veprimitarie dhe marrjen e masave për mos përsëritjen e saj në të ardhmen. Paralajmërimi njoftohet publikisht edhe në faqen e internetit të KQZ.

Kolegë, përfaqësues të partive politike keni ndonjë koment paraprak lidhur me këtë neni? Dakord, nëse nuk ka komente apo propozime atëherë unë mendoj të kalojmë në votim.

Kush është dakord me tekstin e propozuar nga Komisioneri?

**Pro:** *5 (z.nj.Nano, z.Çela, z.Çaka, z.nj.Vukaj, z.Çakaj)*

**Kundër:** *S'ka!*

Me pesë vota pro miratohet neni 8 i projektvendimit.


Atëherë kalojmë tek **neni 9**, i cili është pjesë e kreut V-së. Vendimmarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Neni 9. Ndalimi i veprimitarive nga KQZ-ja.

Pika 1.

Në rast se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, kryesisht ose me kërkesë të të tretëve, konstaton se veprimitaria publike përbën veprimitari të ndaluar sipas nenit 3, të këtij vendimi, dhe/ose keqpërdorim të burimeve shtetërore, urdhëron ndalimin e zhvillimit të veprimitarisë publike përkatëse. Ndalimi kryhet nëpërmjet vendosjes

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*  
*Komisioneri Rregulator*  
*Dt.23.12.2020*

së shënimit “Ndaluar nga KQZ-ja” në ndërfaqen e raportimit, në pjesën që i takon veprimtarisë.

Pika 2.

Personat e tretë që paraqesin kërkesën te Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve për të kerkuar ndalimin e një veprimtarie publike, duhet ta paraqesin atë jo më vonë se 3 (tre) ditë nga data e planifikuar e mbajtjes së saj. Kërkesa paraqitet në Komisionin Qendoror të Zgjedhjeve, nëpërmjet ndërfaqes, me postë, dorazi ose nëpërmjet adresës zyrtare të e-mail-it. Kerkuesi, i cili mund të jetë person fizik/individ ose person juridik, jep të dhënat personale të identifikimit, adresën e banimit/selisë dhe numrin e telefonit. Komisioneri bën shqyrtimin administrativ të kerkesës dhe vendos në lidhje me të jo më vonë se 2 (dy) ditë para zhvillimit të veprimtarisë.


Pika 3.

Ndalimi i zhvillimit të veprimtarisë ose aktivitetit publik bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionerit, i cili shfaqet publikisht në ndërfaqe jo më vonë se 2 (dy) ditë para afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë publike. Shfaqja e shënimit “Ndaluar nga KQZ-ja” në ndërfaqe në mënyrë publike dhe me akses të lirë të publikut përbën edhe njoftimin zyrtar për vendimmarrjen e Komisionerit te raportuesit, sipas pikës 4, të nenit 4, të këtij vendimi.

Pika 4

Për veprimtarinë publike “Ndaluar nga KQZ-ja”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve njofton menjëherë zyrtarisht edhe Autoritetin e Mediave Audiovizive. Veprimtaritë e ndaluara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk lejohet të transmetohen apo të pasqyrohen në rubrikat e lajmeve apo ato që mbulojnë fushatën në radio dhe televizione. Transmetimi ose pasqyrimi i tyre në kundërshtim me ndalimin e vendosur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ngarkon me përgjegjësi, sipas Kodit Zgjedhor, transmetuesin radioteleviziv.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

Për nenin 9, a ka propozime, diskutime apo komente nga përfaqësuesit e partive politike?!

**Z.A.Kazaj, përfaqësues i LSI:** Në pikën 2 të nenit 9, mendoj se në vend të fjalës kërkesë duhet të vendosim fjalën *ankesë*.

**Znj.I.Nano:** Në fakt në nenin 92, pika 4 që i është referuar Komisioneri dhe ne thuhet “Në rast se KQZ-ja kryesisht apo me kërkesë të të tretëve konstaton..”. thënë me fjalë të tjera konstatuesi kërkon konstatimin e veprimtarisë së ndaluar. Pra, terminologjinë është ajo që ka përdorur edhe ligji.

**Z.D.Çaka:** Për më tepër thotë kërkuesi e jo ankuesi.


**Znj.I.Nano:** Pasi në terma kohore po flasim për një periudhe para së të zhvillohet veprimtaria. Koment tjetër?!

**Z.I.Celibashi:** Në fakt, kjo është një ankesë por thjesht formulohet si fillim në formën e një kërkese. Pra paraqet një ankim në formën e kërkesës. I kemi qëndruar strikt përcaktimit të Kodit Zgjedhor.

**Znj.H.Vukaj:** Një sugjerim të vogël, nëse keni shteruar përgjigjen për zotin Kazaj, nëse mundem?

**Znj.I.Nano:** Po zonja Vukaj!

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioneri Rregullator*

*Dt.23.12.2020*


**Znj.H.Vukaj:** Meqenëse media ekziston në disa formate, dhe nuk e ndalojmë dot një person që të paraqesë ankesë edhe në një media të formave apo platformave elektronike, mos do të duhet të shtojmë edhe autoritetin përgjegjës, AKEP-in, pas AMA-s?! Sepse nuk mund ta ndalojmë askën asnë version alternativ tjetër.

**Znj.I.Nano:** Në fakt e kemi diskutuar. Mendoj edhe pse teknologjia ka ecur kaq shumë, ndoshta Kodi Zgjedhor apo më mirë të themi, ligjvënësi nuk e ka përfshirë në këtë mënyrë. E kanë vënë fokusin në rubrikat e lajmeve, neni 92/6ose rubrikat që mbulojnë fushatën në radio e televizione. Do të thotë deri këtu ka dashur ligjvënësi ta kufizojë këtë përbajtje. Në qoftë se në një emision përfëmijë një "x" tv transmeton një veprimtari të ndaluar është përgjegjësia e tij pastaj..

**Znj.H.Vukaj:** Meqenëse autoriteti që mbulon kontrollin, le të themi të veprimtarive jo të ligjshme të mediave AMA, përmban në ligjin e tij edhe versionet satelitore të shfaqjeve të programeve apo të bëra mediatikisht, dmth e ka çelur një lloj variacioni për të konsideruar edhe të tjera. Nuk e di nëse Komisioneri si e konsideron pritshmërinë e zbatimit të këtij akti dhe rezultati që do të sjellë.

**Z.I.Celibashi:** Në fakt, përmua është pak e çuditshme që ligji e ka kufizuar këtë gjë në radio dhe në televizione, madje edhe këtu ka specifikuar vetëm lajmet dhe emisionet që mbulojnë fushatën. Duket së për çdo aspekt tjetër të programacionit të radios dhe tv.nuk do të këtë ndalim, por që, në të vërtetë, nuk është aspak kështu. Për platformat e tjera si psh gazetë media e shkruar, media e printuar, etj., nuk ka ndalim. Do të duhej të kishte ndalim edhe këtu. Por ligjvënësi nuk e ka përfshirë dhe ne i kemi qëndruar besnik ligjit. Edhe pse në këndvështrimin tim do të duhej të kishte një zgjerim mjeteve të komunikimit që bën pasqyrimin dhe rrjedhimisht

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

dhe ndalimin e tyre. Por është kaq e pafund sa dhe ne nuk mund t'i listojmë dot këto mjete.

**Znj.H.Vukaj:** Në referimin që në i bëjmë si juristë, dakord kështu është, deri këtu shkon përmbajtja e kodit. Këtë na e provoi 2017, nëpërmjet VKM që doli dhe që pranonte çfarëdo lloj mjeti të mundshëm të komunikimit publik. Për publikun nqs do të duhet të pasqyrojë një fakt që e ka marrë nga një media që është ekspozuar në një mënyrë tjetër alternative jo në atë formën klasike që ne njohim? Si do ta konsiderohet në këtë rast?


**Z.I.Celibashi:** Këto ka përcaktuar kodi. Media tjetër alternative mund të jetë aplikacion mund të jetë platformë online, etj. Këtu duhet pasur në vëmendje edhe juridikioni territorial, qoftë i KQZ-së, apo edhe i institucioneve të tjera shtetërore.

**Znj.H.Vukaj:** Përsëris, nëse si juristë po të ecim me deduksionin paralelisht me ligjet e tjera, do të mendonim që ose do të kërkonim nëse këto media janë të regjistruara sipas ligjit për shoqëritë tregtare, dhe a përbejnë person juridik apo fizik, pra a kanë një NIPT në fund të fundit, një bazë ligjshmërie që në t'i merrnim në konsideratë? Mos ndoshta nuk do të doja të bëja një propozim, por duhet t'i japim kohë ta diskutojmë këtë aspekt.

**Z.I.Celibashi:** Çdo listë tjetër jashtë citimit të ligjit, mendoj së askush nuk do të jetë kundër. Gjithë problemi ngelet tek vështirësia e përkufizimit.

**Znj.I.Nano:** AKEP-i nuk është institucion rregulator, kaq thotë Kodi. Kodi ka trashëguar një mentalitet të vjetër, edhe pse kjo pjesë është bërë në Korrik 2020,

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Rregulator  
Dt.23.12.2020*

ose ligjvënësi ka dashur vetëm këtë kufizim. Më bën pak sens pasi nga AMA në fushatë zgjedhore kontrollohet minutazhi i vënë në dispozicion për veprimtaritë e partive politike dhe paraqitja e tyre në rubrikën e lajmeve. Megjithatë pavarësisht gjithçka që në themi dhe që veçanërisht, zonja Vukaj paraqiti, mesa duket kodi na ka lidhur duart për të bërë ndalime të tjera që shkojnë përtej kodit. Kështu që nuk e di nëse kolegët e tjerë kanë ndonjë gjë për të diskutuar apo ta kalojmë për votim? Nëse jo, atëherë të nderuar kolegë kalojmë në votim nenin 9 sipas propozimit të Komisionerit!

***Kush është dakord me nenin 9?***

**Pro:** 5 (znj. Nano, z. Cela, z. Çaka, znj. Vukaj, z. Çakaj)

**Kundër:** S'ka!

Me pesë vota pro miratohet nenii 9 i projektvendimit.

Po kaloj në leximin e nenit 10.

Neni 10.

Sanksionet administrative.


Pika 1.

Në rastet kur subjektit e parashikuara në pikën 4, të nenit 4, të këtij vendimi, nuk raportojnë, raportojnë pjesërisht, ose zhvillojnë veprimtarinë pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioneri Qendor i Zgjedhjeve, ndëshkohen nga Komisionieri Shtetëtor i Zgjedhjeve, me gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, sipas nenit 169, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Pika 2.

Në rast se Komisioneri konstaton se titullari i institucionit ka penguar raportimin sipas këtij vendimi, ka ndikuar apo urdhëruar që ai të raportohet me vonesë, apo veprimtaria apo aktiviteti publik zhvillohet pavarësisht ndalimit të bërë nga

*Zbardhi materialin e incizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

Komisioni Qendoror i Zgjedhjeve, titullari i institucionit ndëshkohet nga Komisionieri Shtetëror i Zgjedhjeve me gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë sipas nenit 169, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Pika 3.

Ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të gjobës së dhënë në bazë të këtij nenit. Gjoba e vendosur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve është titull ekzekutiv dhe ekzekutohet sipas procedurave të parashikuara në nenin 510, të ligjit nr.8116, datë 29.3.1996, "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.


Atëherë, nen 10 përmban 3 pika; sanksionet administrative ndaj raportuesve ose atyre që kanë detyrime për ta bërë dhe ndaj titullarëve të institacioneve nëse kanë ndikuar në mosraportim.

Përfaqësuesit e partive politike kanë ndonjë propozim konkret?!

**Z.A.Kazaj, përfaqësues i LSI:** Sanksionet administrative të parashikuar në nenin 10 nga draftuesi që është Komisioneri, do të duhej të ishin me karakter ndëshkues, si nga pikëpamja administrative ashtu edhe nga pikëpamja penale. Kjo do të ishte një garanci më tej akoma që të merrte nën përgjegjësi administrative e penale shkelësit. Kjo do të përbente gjithashtu një garanci më tepër për subjektet politike të cilat nuk përfaqësohen në administratë. Do të ishim para një barazimi të qartë. Çdo person, subjekt i këtij vendimi do të ishte më i përgjegjshëm për veprimtarinë e tij personale dhe për pasojat personale penale që do të rëndojnë mbi të.

**Znj.I.Nano:** Zoti Kazaj një diskutim të tillë e kemi bërë edhe me herët në Komisionin Rregulator, së bashku me Komisionerin. Në fakt në këtë nen, ne kemi

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*




*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

vendosur sanksionet ndaj subjekteve që janë të detyruar të raportojnë veprimtarinë e tyre dhe titullarëve të institucioneve duke iu referuar neneve përkatëse, nenit 92. Ajo që unë do të propozoja konkretisht? Apo në fillim dikush tjetër nga partitë politike do të marrë fjalën! Po zoti Çakaj fjala për ju!

**Z.M.Çakaj:** Atëherë në vijim të diskutimit që bëri zoti Kaziaj, në fakt edhe unë e gjej me vend që lidhur me sanksionet administrative të parashikuar tek neni 10 i këtij projektakti, në duhet ti referohemi bazës ligjore të parashikuar nga neni 171, pika 1, ku parashikohen sanksionet administrative të Kodit Zgjedhor. Më konkretisht, më lejoni ta citoj nenin 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor, besoj së jemi fiks në dispozitën e duhur dhe më konkretisht kjo pikë thotë “shkelja e dispozitave të këtij kodi nga anëtarët e komisionit të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra sipas këtij kodi, kur nuk përbën vepër penale dënohet me gjobe nga 30 mijë deri në 90 mijë lekë”. Unë mendoj se qoftë neni 91 apo 92 i Kodit Zgjedhor, qoftë parashikimet ligjore në këtë projektakt që ne po shqyrtojmë dhe miratojmë, ngarkojnë me detyra specifike sekretarët e përgjithshëm apo titullarët e institucioneve, të cilët, nga ana e tyre, duhet të raportojnë për veprimtaritë ose të parandalojnë veprimtaritë e ndaluara. Besoj së baza ligjore e sanksioneve administrative është neni 171, pika 1 dhe masa përkatëse e dënimit. Këtu mund të sanksionojmë edhe një shkelje tjetër që ka karakter administrativ që mund të ishte procedimi penal ose largimi nga puna. Unë mendoj që së pari të biem dakord të ndryshojmë bazën ligjore dhe së dyti të normojmë sanksionin administrativ sipas bazës ligjore të re.

**Znj.I.Nano:** Zoti Çakaj jam dakord me propozimin tuaj, sinqerisht këtë doja edhe unë të propozoja. Gjithashtu, në këtë nen kemi dy kategori zyrtarësh/subjektesh.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioneri Rregulator*

*Dt.23.12.2020*

Kategoria e parë janë personat që kanë detyrimin për të raportuar dhe kategoria e dytë janë titullarët e institucioneve kur mund të kenë penguar personin përgjegjës për të kryer raportimin sipas ligjit. Referuar nenit 92 të Kodit Zgjedhor, raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve publike, agjensive, ndërmarrjeve shtetërore etj., në kllapa sekretarit të përgjithshëm të institucionit ose sipas tyre drejtorit të përgjithshëm apo drejtorit ekzekutiv. Kështu që unë mendoj që propozimi juaj për të ndryshuar masën e sanksioneve duke iu referuar konkretisht nenit 171/1 të Kodit Zgjedhor, do të ishte me vend për pikën 1 për subjektet e parashikuara në pikën 1 të nenit 10 sanksione administrative. Jemi në të njëjtën linjë apo për pikën 2 keni ndonjë mendim, se unë nuk e gjej të mbështetur, sepse detyrime për raportim kanë vetëm personat përgjegjës për raportimin, nuk po i vëmë emër. Edhe në nenin 10, ...


**Z.M.Çakaj:** Në fakt pjesërisht unë e gjej edhe në pikën 2 të paktën nëse Komisioneri Shtetëror kryen hetim dhe konstaton së titullari i institucionit e ka penguar raportimin. Në rastin konkret pengimi i raportimit fare mirë mund të konsiderohet shpërdorim detyre dhe vepër penale dhe janë veprime të ditura këto.

**Znj.H.Vukaj:** A e bëjnë të realizueshëm ndikimin?

**Z.M.Çakaj:** Ky është ushtrim i ndikimit të paligjshëm. Këtu nuk jemi vetëm në kuadër të një sanksioni administrativ, ...

**Z.D.Çaka:** Unë jam dakord me zotin Çakaj, por duhet të kemi parasysh edhe nëse mund ta vendosim këtu, por problemi është së në fund të fundit është edhe kodi.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

**Z.M.Çakaj:** Kodit iu referova edhe unë 171/1.

**Z.D.Çaka:** Unë jam dakord me pikën 1, ..

**Z.M.Çakaj:** Atëherë ta marrim pak në analizë pikën 2.

**Z.D.Çaka:** Unë jam dakord edhe me parimin që masa e ndëshkimit me gjobë duhet të jetë më e madhe, ...


**Z.M.Çakaj:** Jo vetëm me gjobë! Së pari ne kemi kualifikimin e veprës, prandaj kemi edhe një renditje, gjobë nga 3 mijë deri në 90 mijë dhe ligjvënësi ka sankzionuar, se në rast se nuk zbaton detyrimet dhe në rastin konkret personi i ngarkuar me përgjegjësinë, ka detyrën të zbatojë të gjitha detyrimet. Në rast se ai nuk e zbaton është përsëri Komisionari Shtetëror i Zgjedhjeve, që sipas shkallës së fajit, vlerëson për një gjobë 3 mijë lekë apo në 90 mijë lekë; nëse përbën vepër penale apo shkelje administrative, pra tagrin e ka komisionari shtetëror i zgjedhjeve.

**Z.D.Çaka:** Unë e kisha në këtë kuptim që nga persona të ngarkuar me detyra sipas kodit, ... megjithatë...

**Znj.I.Nano:** Zoti Çakaj, propozimi juaj konkret është?!

**Z.M.Çakaj:** Propozimi im konkret është, që në nenin 10 sankzionet administrative, pika 1 dhe pika 2 të ndryshojë baza ligjore dhe nga neni 169 i Kodit Zgjedhor të kalojmë tek pika 1 e nenit 171 të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet së shkelja e

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*




*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

dispozitave të këtij kodi, në rastin konkret të miratimit të këtij projekt-akti nga personat e ngarkuar me këto detyra, sipas rastit ose Sekretar i Përgjithshëm i institucionit ose drejtues/titullar i institucionit, kur pengon personin e caktuar të raportoje, dhe pas hetimit administrativ të Komisionerit ose të penalizohet me sanksionin administrativ me gjobë, 30 mijë deri në 90 mijë lekë, ose kur kemi të bëjmë me vepër penale sigurisht Komisionari Shtetëror i Zgjedhjeve do të bëje denoncimin përkatës në prokurorinë përkatëse për veprën e kryer. Pra të ndryshojë baza ligjore dhe të jetë në diskrecion të Komisionerit Shtetëror masa e dënimit.

**Znj.I.Nano:** Duke qenë që kemi një propozim të ngjashëm mua më duhet të bëj një analizë të shkurtër. Mendoj që nen 171/1 sa i përket sanksioneve administrative, duke iu referuar asaj që kodi thotë “për shkeljen e dispozitave të këtij kodi, nga persona të ngarkuar me detyra sipas këtij kodi”, jo sipas aktit tonë, dhe persona të ngarkuar me detyra sipas këtij kodi janë persona që kanë detyrimin të raportojnë sipas nenit 92/2. Pra, ne kemi ngarkuar dhe persona të tjerë me detyra nëpërmjet aktit tonë. Ndërsa shkelja e tyre nga persona që kodi i ka ngarkuar përbën kundravajtje dhe dënohet me gjobë sipas nenit 171/1.

**Z.M.Çakaj:** Zonja Nano nuk është vetëm ajo! Është edhe nen 91/4 e Kodit Zgjedhor, që parashikon dhe veprimtaritë e tjera. Më lejoni ta citoj “katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi miratimi ose nxjerra e akteve ligjore dhe nënligjore, të cilat parashikojnë dhënen e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë”. Këtë nuk e bën sekretari i përgjithshëm. Këtë e bën titullari. Pra, përveç raportimit kemi edhe veprime të tjera të cilat janë tagër i titullarit të institucionit. Në këtë kontekst unë mendoj që të dy kategoritë, si sekretari i përgjithshëm si titullari i institucionit,

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

ndodhen në kushtet kur potencialisht në se e kryejnë këtë shkelje mund të marrin sanksione të parashikuar nga neni 171/1, të dy kategoritë.


**Znj.H.Vukaj:** Të gjithëve ne, kolegë të nderuar, na bëri përshtypje me herët këto marzhe gjobash dhe menduam që a do të kishin ndikim për të detyruar personin përkatës që të mos e bënte atë veprim. Pra të reflektonte duke parë masën e gjobës, të stepej në kryerjen e veprës. Në lodhje e sipër dhe nga gjithë këto ditë diskutimi nuk gjetëm një bazë ligjore. Duke shfletuar më pas pamë nenin 171/1 dhe mendoj se me argumentin e sjellë nga zoti Çakaj për nenin 171/1 mendoj së kjo procedurë i shkon përshtat të gjithës. Pikësëpari duhet kategorizuar nëse është vepër penale apo shkelje administrative.

**Znj.I.Nano:** Pra formulimi zonja Vukaj duhet “kur nuk përbën vepër penale dënohet me ....”

**Znj.H.Vukaj:** Në këtë pikë ishte i qartë zoti Çakaj. Të mos krijojmë edhe përsëritje

**Znj.I.Nano:** Atëherë po hedh në votim propozimin e zotit Çakaj lidhur me pikën 1 të nenit 10. Të nderuar kolegë kalojmë në votim pikën 1 të nenit 10 sipas propozimit të zotit Çakaj! Po hedh në votim propozimin e zotit Çakaj për pikën 1 të nenit 10. Pra, në pikën 1 të nenit 10 do të ndryshojë referenca ligjore pra do të jetë nenit 171, pika 1 e Kodit Zgjedhor dhe masa e gjobës në përputhje me këtë nen dhe do të shtohet shprehja “kur nuk përbën vepër penale dënohet me gjobë nga 3000 lekë deri në 90000 lekë, sipas nenit 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor”. Zoti Çakaj ky është propozimi juaj?

*Zbardhi materialin e incizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

**Z.M.Çaka:** Po!

Kush është dakord?

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka

Me pesë vota pro miratohet propozimi i zotit Çakaj.

I njëjti propozimi është bërë nga zoti Çakaj edhe për pikën 2. Unë paraprakisht e deklaroj votën kundër jo se jam kundër në parim por nuk gjej mbështetje tek 171/1.


Kjo është bindja ime.

**Z.M.Çakaj:** Zonja Nano, më falni, të sqarojmë edhe diçka. Nëse në pikën 1 ishte e qartë së çfarë detyrash kishte personi i ngarkuar për të kryer këto veprimtari, së pari pra raporton apo jo, së dyti, raporton pjesërisht dhe së treti zhvillon veprimtarinë, unë mendoj që është shumë e nevojshme ta sqarojmë në pikën 2 se bëhet fjalë për ato raste kur titullari i institucionit ka penguar raportimin. Pra, në gjykimin tim individual, personal, shkelja e titullarit të institucionit është edhe më e rëndë pasi me veprimet e tij të vullnetshme dhe në mënyrë të njëanshme ka penguar raportimin dhe qartazi në rastin konkret kemi të bëjmë me shpërdorim detyre apo shkelje të një karakteri edhe më të rëndë. Në këtë kontekst, gjoba do të jetë edhe më e rëndë sipas parashikimit ligjor, nga 30 mijë deri në 90 mijë.

**Znj.I.Nano:** Për mua gjoba do të duhej të ishte edhe më e madhe, ...

**Z.M.Çakaj:** Natyra e shkeljes në pikën 2 është shumë më e rëndë së sa në pikën 1. Sepse në pikën dy me ndërgjegje të plotë titullari e ka penguar raportimin. Pra, kemi të bëjmë me një vepër penale. Kështu që në këtë kontekst shiheni.

*Zbardhi materialin e incizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

**Znj.I.Nano:** Kur nuk përbën vepër penale sikundër thatë ju atëherë përsëri mbetemi në dënimin me gjobë. Personalisht, nëse do gjenim një bazë më të fortë se kjo... nuk dua të ndikoj asnjë nga kolegët, më ku toni është thjesht bindja ime. ... Gjithsesi unë do ta hedh për votim propozimin tuaj.

**Znj.H.Vukaj:** Pika 2 mund të shërbente si justifikim konkret që pengimin e bën titullari pasi ai dënohet me një gjobë, nga e cila ai nuk ndikohet fare dhe justifikon edhe të ngarkuarin për të raportuar në këtë rast.

**Znj.I.Nano:** Sa i përket titullarit është diçka që ligji nuk e ka parashikuar. Ne, në ushtrim të detyrës tonë, dhe përgjegjësisë që na ka ngarkuar kodi e kemi shtuar këtë. Pra, detyrimi nga Kodi është vetëm për raportuesin, pra personin përgjegjës për raportim. Prandaj ndoshta nuk e gjej këtë mbështetje. Gjithsesi unë do ta hedh në votë edhe pse do të doja shumë të gjenim një sanksion edhe më të fortë se sa personi përgjegjës për raportimin. Po hedh në votë propozimin e zotit Çakaj. I njejti propozim i zotit Çakaj është për pikën 2. Kur nuk përbën vepër penale dënohet nga Komisioneri me gjobë nga 3000 lekë deri në 90000 lekë sipas nenit 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Kush është dakord?

**Pro:** 2 (znj.Vukaj, z.Çakaj)


**Kundër:** 3 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka)

Nuk miratohet! Janë dy vota pro dhe tre kundër!

Zoti Çaka mundet ju ta lexoni nenin në vijim, ju lutem?!

**Z.D.Çaka:** Pika 3 e nenit 10, citoj:

*Zbardhi materialin e incizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Rregulator  
Dt.23.12.2020*

Ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të gjobës së dhënë në bazë të këtij nenit. Gjoba e vendosur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet sipas procedurave të parashikuara në nenin 510 të ligjit 8116 date 29.03.1996, Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

**Z.I.Celibashi:** Mbase mund të them unë diçka. Edhe pse duket shumë formale, por edhe për shkak të mungesës së kohës për të dhënë efekte, secili prej këtyre akteve që ndërmerr Komisioni, është parashikuar që ankimi ndaj këtyre vendimeve të mos ketë pezullim të ekzekutimit të tyre. Kjo është ideja. Edhe nëse ka ankim ekzekutimi i pezullimit të gjobës nuk pezullohet. Ndryshe nuk do të kishim efekt. Thjesht është racionale që të mos ketë pezullim të ekzekutimit të gjobës me paraqitjen e ankimit, sepse afatet janë shumë të ngushta dhe fushata zgjedhore është në një periudhë shumë të shkurtër dhe nuk do të kishte sens që të pezullohej vendimi i dhënies së gjobës, ky ishte qëllimi.

**Znj.I.Nano:** Kolegë, nëse nuk keni propozime për ndryshime apo shtesa edhe mbas sqarimeve të dhëna nga Komisioneri, ju ftoj të kalojmë në votim.

Kush është dakord sipas tekstit të ardhur nga komisioneri.


**Z.M.Çakaj:** Pika 1 u votua, pika 2 ra dhe ngeli varianti që ishte dhe pika 3 është përsëri varianti i Komisionerit.

**Znj.I.Nano:** Atëherë, neni 10 me ndryshime ta votojmë edhe një herë?!

**Kush është dakord me nenin 10?**

**Pro:**           *5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)*

*Zbardhi materialin e incizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*  
*Komisioneri Rregulator*  
*Dt.23.12.2020*

**Kundër:** *S'ka!*

Faleminderit, me pesë vota pro miratohet nenii 10, me ndryshimin e propozuar nga zoti Çakaj në pikën 1 të këtij nenii.

Atëherë kalojmë tek nenii 11.

**Neni 11.**

Ankimi ndaj vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Ndaj vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve që ndalon realizimin e veprimtarisë publike ose vendimit të ndëshkimit me gjobë mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, përkatësisht, brenda 3 (tre) ditësh nga shfaqja e shënimit “Ndalur nga KQZ-ja” në ndërfaqen e raportimeve ose marrja dijeni për gjobën.

Ky është një parashikim i Kodit Zgjedhor për ankimin në KAS, referuar kësaj kategorie të vendimeve të Komisionerit. Ka ndonjë koment nga partitë politike?!

Po nga anëtarët e Komisionit Rregulator?!

Nëse nuk ka komente votojmë edhe nenin 11.

**Kush është dakord me nenin 11?**


**Pro:** *5 (z.nj. Nano, z. Cela, z. Çaka, z.nj. Vukaj, z. Çakaj)*

**Kundër:** *S'ka!*

Me pesë vota pro miratohet edhe nenii 11. Atëherë të nderuar kolegë, ...

**Z.I.Celibashi:** Zonja Nano nëse ka mundësi. Duket që tani kanë ngelur dy dispozitat e fundit që kanë të bëjnë me ankimin kundër aktit tuaj dhe me hyrjen në fuqi të këtij akti. Sikurse ju ratë dakord, që shqyrtimi i atyre pikave apo neneve të këtij akti për të cilat nuk ka dakordësi të plote ndërmjet jush dhe për të cilat ka një rëndësi të dorës së parë edhe për subjekte të tjera të interesuara ta bënët në fund këtë shqyrtim. Unë duke marrë në konsideratë edhe kohën, por edhe interesin e të

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioneri Rregulator*


*Dt.23.12.2020*

gjithëve për të ardhur me një formulim për ato pika për të cilat kemi pikë-vështrime të ndryshme, do t'ju propozojë juve apo kujtdo prej anëtarëve që të shtyjmë mbledhjen, ndërkoq që edhe komisionerit i jepni kohë për të bërë edhe ai një reflektim të përbajtjes së atyre pikave për të cilat duket që nuk kam një dakordësi dhe që ka një interes të dorës së parë. Është në interesin e të gjithëve dhe nuk ka asnjë lloj problemi nëse do të jemi pragmatistë procedural. Kështu mendoj unë, pasi në fund të fundit, ka shumë mundësi që akti të gjëzojë kuptueshmërinë e të gjithëve dhe pranimin e të gjithëve si i tillë, ju faleminderit!

**Znj.I.Nano:** Faleminderit Komisioner! Unë në fakt nuk kisha ndërmend të vijoja me dy nenet e fundit që janë në rradhë. Ne i ndërprenë votimin tek nenit 3 që ndoshta duhet t'i japim kohë vehtes, administratës si dhe subjekteve. Ndoshta e gjithë trajtimi që i bëmë punës së deri tanishme ka nevojë për ti dhënë vetes kohën e duhur për të gjetur formulimet e duhura por edhe administratës së KQZ-së, si dhe subjekteve shumë të interesuara për këtë vendim, sikundër e thamë shumë të rëndësishëm, në mënyrë që të finalizohet me sukses. Deri tani ajo ç'ka arritëm besoj është shumë e rëndësishme. Sikundër edhe zonja Vukaj e theksoj në diskutimin e saj, që në parim ky do të ishte një hap i parë i mundësuar nga një organ si KQZ-ja, për të ndaluar me një akt që buron nga Kodi Zgjedhor. Në vijim të këtij diskutimi unë do ti propozojë kolegëve dhe mbledhjes së Komisionit Rregulator, që këtë seancë ta shtyjmë, të mos e konsiderojmë të mbyllur sot por ta shtyjmë, për shkak edhe të orës së vonë në të cilën zhvillohet. Më lejoni edhe një propozim për ditën e nesërme, në orën 12 të mos harrojmë që kemi edhe një seancë tjeter publike nesër pasdite për një akt tjeter. Këtë akt e vlerësojmë shumë të rëndësishëm, dhe po japim kohën të gjitha institacioneve që të reflektojnë pasi nga data 25 dhjetor fillon veprimi i këtij akti.

*Zbardhi materialin e incizuar*

*Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

**Z.M.Çakaj:** Zonja Nano, unë do propozoja diçka në lidhje me nesër ku ne do të kemi një akt tjeter që na është paraqitur nga komisioneri për miratim. Nesër, ose para ose pas miratimit të atij aktit tjeter, me qëllim që t'i japim vetes edhe palëve më shumë kohë në dispozicion, sa po të mbarojmë me aktin tjeter, vijojmë aty ku e kemi lënë sot në nenin 3 në pikën 1.3. Besoj është më mirë kështu!

**Znj.I.Nano:** Nuk e di nëse kolegët?! Atëherë nesër e kemi njoftuar publikisht mbledhjen për në orën 17:30.


**Z.D.Çaka:** Unë kisha një sugjerim tjeter që të linim një orë tjeter për mbledhjen e sotme, mbase edhe më herët së ora 17:30.

**Z.M.Çakaj:** Nëse nuk doni t'i lëmë të dy mbledhjet në vijimësi të njëra tjetrës, atëherë e bëjmë diku nga ora 15:00.

**Z.I.Celabashi:** Për mua do të ishte më mirë që nesër në 17:30 të ishte mbledhja tjeter e Rregulatorit, e programuar tashmë dhe bashkë me këtë aktin t'i vijonim njëra pas tjetrës. Pra të mos e ndanim ditën në dy mbledhje. Besoj do të ishte përfituese edhe për ju besoj.

**Znj.I.Nano:** Atëherë, të nderuar kolegë nesër në orën 17:30 ne kemi njoftuar zyrtarisht seancën e mbledhjes së radhës të Komisionit Rregulator. Në përfundim të seancës së nesërme do të vijojmë me mbledhjen që po e ndërpresim sot, ose e kundërsa do të vijojmë me pjesën e mbetur të seancës së sotme dhe pastaj me mbledhjen e programuar për nesër. E lëmë për në 17:30, për nesër?!

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.23.12.2020*

Të gjithë janë dakord!

**Znj.I.Nano:** Lutem që administrata që është e pranishme të marrë masa për përgatitjen e materialeve për seancën e sotme por edhe për atë të nesërmen. Faleminderit! Unë po e deklaroj të mbyllur për sot me vendimin e përbashkët me konsensus për të shtyrë seancën. Pra, nesër në 24.12.2020 në orën 17:30 dhe kjo vlen edhe si një njoftim zyrtar, ju lutem Sekretar i Përgjithshëm, natën e mirë!

**Vendimi nr.9**

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.24.12.2020*

24.12.2020

Ora 18:00

***RENDI I DITËS***

*Projektakti “Rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.*

**PJESE MARRJA :**

• **KQZ:**

• Ilirjan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

• **Komisioni Rregulator:**

• Ilirjana NANO Kryetar

• Arens ÇELA Anëtar

• Dritan CAKA Anëtar

• Helga VUKAJ Anëtar

• Muharrem ÇAKAJ Anëtar

• Stafi KQZ Y.Merkaj, M.Koja

• Parti Politike PD, LSI, PS

• **Vëzhgues:**

**Znj.I.Nano:** Përshëndetje të nderuar Kolegë! I nderuar Komisioner, të nderuar përfaqësues të partive politike, pasi mbyllëm mbledhjen e njofuar zyrtarisht për sot riçelim mbledhjen e cila u shty nga dita e djeshme. Më duhet thjesht në mënyrë

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Romina Kondraxhiu*

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioni Rregulator*

*Dt.24.12.2020*

të përbledhur, edhe për ata që kanë hyrë sot në këtë mbledhje, të theksoj faktin që dje në mbledhjen e tij publike Komisioni Regulator shqyrtoi, miratoi në parim, miratoi dhe një pjesë të neneve të projektvendimit për rregullat dhe raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik dhe me kapital shtetëror, agjensive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimeve e veprimtarive të ndaluara si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve. Nga dita e djeshme diskutimet kanë mbetur në nenin 3, konkretisht në pikën 1/3. Ditën e djeshme rrëzua një propozim i zotit ÇELA, ndërkohë për këtë pikë të nenit 3 ka patur propozime zoti Dritan Çaka, unë gjithashtu kam patur një propozim dhe një propozim për një shtesë zoti Çakaj. Kështu që e nisim aty ku e lamë dje, personalisht propozimi im kur bëhej fjalë për veprimtari të ndaluara do të quhen edhe ato që lidhen me legalizimet, pra ndalimin e , dhënes së certifikatave të legalizimeve në seanca ose në veprimtari publike e thënë me fjalë të tjera personalisht kërkova dje të shtohej edhe fjalë ose shprehja përvçse në sportel, duke patur parasysh fakt që të mos krijohet tek qytetarët ndonjë ide e gabuar, që jemi duke ndaluar procesin e legalizimeve, gjithsesi nëpërmjet diskutimeve të kolegëve dje, vlerësoj që ta tërheq këtë propozim për shkak se duke qenë vetë neni është përjashtues, pra veprimtari të ndaluara janë edhe ato që përfshijnë shpërndarjen në veprimtari publike, besoj që është e kuptueshme që veprimtaria në sporele nuk ndalohet kështu që nuk do të hidhet për votim. Ndërkohë kemi propozimin e zotit Çaka dhe zotit Çakaj, ndërkohë në këtë mbledhje sot është bashkuar edhe përfaqësuesi i Partisë Socialiste Eridian Salianji, i cili nuk ka qenë në ditën e djeshme, kështu që të paktën në këtë pikë është i ftuar të japë nëse ka

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Romina Kondraxhiu*

*P. Gulashy*

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioneri Rregulator*

*Dt.24.12.2020*

ndonjë propozim, ndonjë sugjerim konkret apo ndonjë koment, ndërkokë zoti Salianji siç ju thamë nenet e tjera janë miratuar. Zoti Çaka, më pas zoti Çakaj.

**Z.D.Çaka:** Atëherë, edhe mbas diskutimeve që janë bërë edhe më përpara edhe sqarimit edhe dje në lidhje me këtë pikë edhe Komisioneri bëri, në kushtet kur kjo shpërndarje e lejeve të legalizimeve apo e çertifikatave të pronësisë të çdo lloj titulli pronësie të cilat unë kisha propozuar për të shtuar një togfjalësh me përjashtim të veprimtarisë së shpërndarjes në sporte, duke qenë se edhe nga sqarimet që u bënë edhe nga Komisioneri edhe nga diskutimet është po e njëja situatë dhe interpretim që ju kryeatre bëtë, edhe unë tërhiqem nga ky propozim duke qenë se dhe vetë dispozita e përmban atë pjesë të propozimit që unë kisha bërë ditën e djeshmë dhe në këtë formatin që është bërë nga Komisioneri është shteruese, pra edhe unë e tërheq propozimin tim. Faleminderit!

**Znj.I.Nano:** Faleminderit Z.Çaka. Z.Çakaj mund të shprehni në raport me propozimin tuaj. Ju patët propozim për një shtesë.

**Z.M.Çakaj:** Po e nderuar, faleminderit znj.Nano, Atëherë propozimi im i djeshëm, të cilin do ta ripërsëris tanë konsiston në faktin se, pas pikës 3 të shtohet pika 4 me këtë përbajtje, pra jemi në nenin e veprimtarive të ndaluara. Dhe të shtohet pika 4 me përbajtje, 4 muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve ndalohet dhënia e kontratave publike të koncessionit PPP, për të cilat nuk është bërë njoftim publik se do të zhvillohen, nuk janë vijim i një procedure koncesionare të identifikuar dhe nisur, apo nuk janë parashikuar për tu financuar nëpërmjet buxhetit të miratuar të vitit zgjedhor dhe në vijim pika 4 të kalojë pika 5 dhe pika 5 të kalojë pika 6.

**Znj.I.Nano:** Domethënë kontrata publike te koncesionit/ Partneritet Publik Privat.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Romina Kondraxhiu*

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.24.12.2020*

**Z.M.Çakaj:** Po.

**Znj.I.Nano:** Jo meqënëse e thatë PPP, thashë për publikun, për stenografët,

**Z.M.Çakaj:** Po. Partneritet Publik Privat.

**Znj.I.Nano:** Z.Salianji, meqënëse nuk ka qenë në mbledhjen e djeshme ky është një propozim që është bërë dje dhe është ri formuluar, pra ri bëhet sot, po, nuk dëgjoheni ju lutem,

**Z.I.Salianji(Përfaqësues i Partisë Socialiste):** Së pari doja tju thoja, që ky propozim nuk gjen pasqyrim në Kodin Zgjedhor në nenin 91, pika 4, ku fare qartë ligjvënësi e ka përcaktuar se katër muaj përpara datës së zgjedhjeve janë kufizimet përkatëse ku janë heqja, ulja e taksave, amnistia fiskale, e të tjera që ju i keni diskutuar. Ky është një propozim i ri ekstra ligjor, pra nuk është një propozim i mbështetur në Kodin Zgjedhor, por është një propozim që bëhet tashmë për tu futur në udhëzim. Unë do të thoja që ndalimi i kontratave publike koncesore nuk është pjese e ndalimit të kësaj dispozite, sepse këto kontratat nuk përfitohen nga kategori të caktuara të popullsisë, por vetëm nga persona të caktuar të cilët mund të jenë në raste të caktuar edhe persona ndërkombëtarë, juridikë ndërkombëtarë të cilët nuk kanë ndikim fare në procesin zgjedhor. Megjithatë ky propozim nuk është se dëgjohet për herë të parë nga opozita, ky është një propozim mesa kam dijeni nga përfaqësues të Partisë Socialiste, është diskutuar dhe në marrëveshjen e 5 Qershorit dhe disa nga pjesëtarët e asaj marrëveshjeje janë dhe aty në sallë dhe pas diskutimeve edhe vetë forcat politike nuk kanë arritur dakordësinë për ta përfshirë

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Romina Kondraxhiu*

*P. Gullozy*

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.24.12.2020*

këtë pikë në ligjin, në Kodin e ri Zgjedhor. Tashmë pas 5, 6 muajsh po ripërsëritet prapë kjo kërkesë, unë do të thoja që përsa i përket PPP-ve ose Koncessionet, Partia Socilaiste nuk ka asnje lloj ndikimi, në të cilin ky proces të ndikojë në procesin zgjedhor, por nuk ka as edhe një lloj dëshire që të bëjë me dije publikun që nëpërmjet këtyre koncesioneve edhe PPP-të të ndikojnë në këtë proces, por meqënëse kjo është bërë në këtë mbledhje dhe mbledhjet më përpara mesa shikoj kalë beteje për miratimin e këtij akti, opozita tashmë, veprimtarinë normale të një shteti të së drejtës që janë dhe koncessionet edhe PPP-të, të cilët janë për zhvillimin e shtetit dhe jo nuk e di se ku e gjejnë mënyrën dhe arsyetimin se ku mund të ndikojnë këto, kur një person juridik i cili merr një PPP mundet që të ndikojë për votuesit. Megjithatë, unë do të thoja që, ju jeni organi i cili e vendosni pavarësisht, nuk është në Kodin Zgjedhor, unë nuk e di sesi ju do arsyetoni vendimarrjen tuaj, Arsyetuesi biles duhet të gjej së paku dispozitën ligjore të cilin do ta mbështesi në udhëzm, se udhëzimi nuk mund të dali përtej ligjit. Ne për të hequr çfarëdo lloj dyshimi dhe çfarëdo lloj hamendësie të cilës mund të ndodhi gjatë procesit zgjedhor, ne duke qenë se jemi në kuadrin se gjithmonë opozitës ja kemi pranuar çfarë ajo ka kërkuar në lidhje me përgatitjen e procesit zgjedhor, unë do të thoja që ne nuk e kundërshtojmë këtë propozim dhe këtë do ja lejmë në përcimin tuaj që ju ta vendosni, pra jeni ju organi që mund të vendosni është apo jo e drejtë përcaktimi i kësaj pike. Ne e kishim në dorë si forca politike dhe si ligjvënës Partia Socialiste në Kuvend nuk e miratoi. Tashmë ka ardhur propozimi përpara jush, ju keni gjithë të drejtën ligjore të vendosni për miratim të saj.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Romina Kondraxhiu*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregullator  
Dt.24.12.2020*

**Z.E.Salianji përfaqësuesi i PS:** Tashmë kjo ka ardhur propozimi përpara jush. Atëhere, ju keni të gjithë të drejtën ligjore të vendosni për miratimin e saj. Nuk e kundërshtojmë këtë pikë, në qoftë se ju gjeni argumentat ligjor për ta parashtruar, atëherë le të hiqet dhe le të përcaktohet dhe ndalimi i konçsioneve dhe i prokurimeve që kjo të jetë besoj dëshira e fundit e pranuar e opozitës nga Partia Socialiste. Faleminderit! Kjo do ishte përfundimi i fjalës time! Para se të mbaroja do iu uroja Krishtlindjet të gjithëve si përfaqësuesve të partive politike edhe ju si anëtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve! Faleminderit!

**Znj.I.Nano:** Faleminderit! Zoti Salianji në fakt ju nuk keni qenë në ditën e djeshme. Dhe dje propozuesi i këtij amendamenti, i kësaj shtese ka argumentuar propozimin e vet, nuk është, mendoj kolegë që nuk është vendi për ta riarsyetuar apo riargumentuar. Nga ana tjetër, pas këtij komenti të gjatë të zotit Salianji, ku në fakt gjatë shqyrtimit nen për nen në përgjithësi presim sygjerime për ndryshime apo shtesa për... pra propozime konkrete për nenin në çdo rast, Komisioni Rregullator është organi që vendos të miratojë apo jo, (dëgjohem kam probleme me internetin). Pra, duke qenë Komisioni Rregullator organi, një nga organet drejtuese që ka atributin të miratojë aktet normative dhe kjo është pjesë e aktit normativ që ne shqyrtuam në 90% dje. Unë do të ftoja kolegët të kalojmë, pra dy propozime u tërhoqën, dhe kemi për të votuar në këtë pikë vetëm propozimin e zotit Çakaj që sikundër e theksova është argumentuar që ditën e djeshme në mbledhjen e cila u shty për sot. Të nderuar kolegë kush është dakord me shtesën e propozuar nga zoti Çakaj?

**Znj.H.Vukaj:** Më faln i zonja Nano, sikur dëgjova që dikush ka kërkuar fjalën? Më duket se zoti Kaso.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Ardita VRIONI*

*P. Ulloay*

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.24.12.2020*

**Znj.I.Nano:** Po. Zoti Kaso ju vjen keq tiu jap fjalën menjëherë pas votimit pasi e hodha në votim.

**Z.I.Kaso, përfaqësuesi i PD-së:** Po, votojeni.

**Znj.H.Vukaj:** Edhe diçka tjetër, dëgjova që zoti Salianji, përmendi edhe prokurimet, mos ndoshta duhet të fusim edhe prokurimet!

**Znj.I.Nano:** Keni propozim konkret zonja Vukaj?

**Znj.H.Vukaj:** Jo, në shqyrtimin që ai ka bërë mos ndoshta mendon që në këtë lëshim të jenë edhe prokurimet. Pra, është një lloj lëshimi që ai si përfaqësues i Partisë Socialiste mos ndoshta ka menduar që duhet të jenë edhe prokurimet.

**Znj.I.Nano:** Unë nuk dëgjova propozim nga ana e zotit Salianji.

Keni zoti Salianji propozim për këtë nen, propozoni për shtesë, ndryshim? Nuk dëgjoheni ju lutem!

**Z.E.Salianji përfaqësuesi i PS:** Në lidhje me propozimin e bërë, unë bëra objekzionet e mia, nuk kam asnje lloj propozimi.

**Znj.I.Nano:** Në rregull! Faleminderit! Atëhere, votojmë propozimin e zotit Çakaj!

**Kush është dakord me propozimin e zotit Çakaj?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj,z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka!

**Miratohet!**

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Ardita VRIONI*

P *Dulaliu* 4

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregullator  
Dt.24.12.2020*

**Znj.I.Nano:** Zoti Kaso, ju lutem!

**Z.I.Kaso, përfaqësuesi i PD-së:** Shumë shkurt zonja Kryetare, sepse ju e miratuat, do të kishte vlerë për ata që na ndiqnin që, sepse nuk është e thënë që unë gjithmonë duhet ta marrë fjalën pas zotit Salianji për ta kundërshtuar ose për ta përshëndetur siç mund të ndodhi në këtë rast. Ishte thjesht për të sqaruar ata që po na ndjekin domethënë sepse sqaroi pozicionin e vet Partia Socialiste, të cilën e përshëndes në pjesën që nuk e kundërshtojë amendamentin e propozuar të cilin ju sapo e miratuat. Por dua të saktësoj fjalën që propozimi i bërë së pari njëherë nuk është risi që tejkalon legjislacionin, mjafton të kujtojmë këtu që një VKM me përbatje të ngjashme, ka miratuar po qeveria e mazhorancës pjesë e të cilës është edhe zoti Salianji dhe përfaqëson këtu, madje edhe duke qenë edhe më drastike duke shkuar përtej ndalimit vetëm të koncessioneve në periudhën para zgjedhore por në atë të ndalimit të tenderave dhe të prokurimeve përvçse ato të domosdoshme për funksionimin normal të shtetit. Pra, eksperiencia të tilla ka pasur dhe është konsideruar që atëhere nga vet forca e tij politike mundësi abuzimi me burimet e jo vetëm të administratës shtetërore por me burimet shtetërore në përgjithësi dhe shpërndarja pa kriter ose në mënyrë të nxituar e koncessioneve e parteneriteteve publik -privat por qoftë edhe tenderave dhe prokurimeve me vlera të mëdha të cilat pavarësisht se nuk i shkojnë masës së madhe të zgjedhësve ose të popullsisë iu shkojnë subjekteve të caktuara të cilat kanë nga ana e tyre resurse dhe fuqi të tilla sa të ndikojnë dukshëm procesin zgjedhor siç edhe ka ndodhur për fat të keq edhe në vitin 2017, për fat të keq pavarësisht aktit të miratuar. Pra, desha vetëm tiu sillja në vëmendje gjë që ju e patët në votimin tuaj që nuk jemi në një terren të pashkelur paçka se çdo herë ndërrmarrje të tilla të cilat kufizojnë atë diskrecionin e qeverisë ose të ekzekutivit, kërkojnë edhe guxim nga

*Zbardhi materialin e inçzuar  
Ardita VRIONI*

*P. Dulolaj*

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.24.12.2020*

organet e pavarura, guxim të cilin ju si institucion i pavarur e demostruar edhe në këtë rast me këtë lloj vendimmarrje. Kjo ishte më shumë për të sqaruar pak a shumë kontekstin e propozimit dhe për të shprehur edhe qendrimin e forcës tonë politike që unë përfaqësoj që unë shkurtimisht në mënyrë lakonike shpreha dje dakordësinë tonë si forcë politike për miratimin nga ana juaj ashtu siç ndodhi të këtij amendamenti. I bashkohem, fjalia e fundit, i bashkohem qendrimit të zotit Salianji që përveçëse e pershëndeta që nuk e kundërtoi, i bashkohem edhe urimit për festat pavarësisht se mbledhja nuk ka mbaruar por partitë e mëdha sa larg jemi në qëndrimet politike aq afér jemi në qëndrime të tilla, për përkujtime të tilla siç janë festat, Krishtlindjet, vigjilia e të cilave është sot, të cilët ndoshta e bëjnë këtë vit të vështirë për të gjithë ne, sado pak më të lehtë. Faleminderit!

**Znj.I.Nano:** Zoti Kaso, faleminderit! Më lejoni edhe mua të them dy fjalë pa e zgjatur në fakt ju, zoti Salianji, Kaziaj, përfaqësues të tjera të partive politike, keni një përvojë të gjatë duke përfaqësuar subjektet tuaja politike në Komisionin Qendoror të Zgjedhjeve. Ndërkohë ne këtë vit kemi miratuar rregulloren e funskisionit të Komisionit Rregulator dhe të paktën në asnjë nen të kësaj rregulloreje nuk parashikohet debati në mes të përfaqësuarve të partive politike por iu jepet fjala sa herë që është e nevojshme për të bërë propozime konkrete, sugjerime, apo ndonjë koment, lidhur me projektin ne patëm dje rastin të miratonim për herë të parë propozimin e një subjekti politik. Atëhere, të nderuar kolegë rikthehem i tek akti, besoj që me miratimin e propozimit të zotit Çakaj, lind nevoja për të miratuar nenin 3.

**Kush është dakord me nenin 3 sipas përmbatjes së riformuluar tashmë?**

**Pro:** 5 (zpj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj,z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka!

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Ardita VRIONI*

*P. Dulalay*

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Rregulator  
Dt.24.12.2020*

***Miratohet!***

Administrata i ka mbajtur besoj shënimet që nga dita e djeshme por edhe këtë të sotmin të zotit Çakaj. Do tiu ftoja të nderuar kolegë, më korrigjoni nese kemi lënë diçka pa shqyrtuar nen për nen.

***Znj.H.Vukaj:*** Para se të arrijmë në fund zonja Nano...

***Znj.I.Nano:*** Po zonja Vukaj!

***Znj.H.Vukaj:*** Para se të arrijmë në dispozitën e fundit që e bën edhe përmbyllës procesin, kam një propozim! Të cilin e konsideroj formal por të rëndësishëm që ka të bëjë me evidentimin e anksit që duhet ti bashkëlidhet, të institacioneve që duhet ti bashkëlidhen këtij akti. Me qëllim që akti të bëhet eficent dhe efikas. Faleminderit! Ndoshta si propozim konkret...

***Znj.I.Nano:*** Sapo ne të miratojmë këtë akt është...

***Znj.H.Vukaj:*** Ndoshta duhet ta propozoj tani, sepse duhet të jetë një dispozitë përpara dispozitës përmbyllëse që ky akt hyn në fuqi...

***Znj.I.Nano:*** Nuk kemi një listë të institacioneve, është detyrë e Komisionerit që me hyrjen në fuqi të këtij akti ...

***Znj.H.Vukaj:*** Atëhere, unë propozoj që të ketë një nen të parafundit që në numër përkon të jetë, më falni, atëhere do të thotë që është përpara nenit 12... Propozimi im në fakt duhet të marri numrin 12 nëse do të pranohet të miratohet nga kolegët,

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Ardita VRIONI*

9 *Dulshaj*

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioneri Rregulator*

*Dt.24.12.2020*

dhe ka këtë tekst mundem, mund ta propozoj tekstin: "Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi të gjitha institucionet qendrore- vendore, autonome, më falmi të pavaruara dhe të varësisë sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi si aneks 1." Kjo ti paraprijë nenit ankimi. Nëse Komisioneri do ta facilitonte në zbatimin e këtij akti, dhe do të lehtësonte edhe vizualitetin si detyrim për të gjithë institucionet, unë e gjej me vend ti ftojë edhe kolegët ta bëjmë pjesë integrale të aktit që po miratojmë.

**Znj.I.Nano:** Zonja Vukaj në parim unë jam dakord me ju, po duke mos pasur sot nga ana juaj një listë për ta propozuar nuk kemi çfarë të miratojmë, nuk e di nëse Komisioneri ka diçka për të thënë në lidhje me këtë.

**Znj.H.Vukaj:** Jo.Përmbatjen e nenit duhet të miratojmë, sepse pastaj i mbetet detyrë Komisionerit që të rakordojë me institucionin më të lartë përgjegjës që disponon të gjithë listën e institacioneve, dërgimin e kësaj liste pranë Komisionerit. Sepse unë në vetvete përfaqësoj vetëm një prej anëtarëve dhe nuk kam marrëdhënie as me të tretët që të sillja listën pranë jush të nominuar apo numerike, të të gjithë institacioneve.

**Z.I.Celibashi:** Atëhere, nëse më lejoni të nderuar kolegë, në lidhje me këtë çështje po iu jap informacionin vijues: Në përputhje me ato përgjegjësitë që Kodi Zgjedhor i ngarkon Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve sikurse është edhe prezantimi i këtij akti, ne prej kohësh kemi filluar procesin e përgatitjes si të ndër faqes ku do të bëhen këto raportimet dhe ajo nga data 25 do të jetë e disponueshme, do të jetë online, kundërfaqja e raportimit dhe nga ana tjetër iu kemi dërguar Këshillit të Ministrave, për të dërguar një listë të të gjitha

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Ardita VRIONI*

*P. Ullozi*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioni Rregulator*

*Dt.24.12.2020*

institucioneve që janë nën varësinë e Këshillit të Ministrave dhe iu kemi dërguar gjithashtu një shkresë dhe kërkesë për informacion të gjitha bashkive, pra organeve të qeverisjes vendore për të na raportuar edhe ato në lidhje me të dhënat mbi vetë ato por edhe për institucion apo ndërrmarrje në varësi të bashkive. Iu kemi dërguar gjithashtu ndarë në dy dërgesat e para, një kërkesë të gjitha institucioneve të tjera të pavarura pra që nuk varen as nga Këshilli i Ministrave dhe as nga organet e qeverisjes vendore për ti kërkuar edhe atyre informacion në lidhje me institucionet që eventualisht ato mundet të kenë në varësin e tyre apo edhe në struktura të tjera. Pra, në pikëpamje të një faze, procesi para përgatitor për zbatimin e këtij akti, ne si KQZ-ë të themi e kemi bërë. Edhe pse ka sens plotësisht propozimi i zonjës Vukaj, unë mendoj që nga pikëpamja praktike ne as sot nuk e kemi dhe në ditët në vazhdim ndoshta nuk do ta kemi të plotë se kush do jetë lista e plotë e institucioneve, ndërrmarrjeve të cilat janë të detyruara për të raportuar. Ajo çka kemi identifikuar janë këto institucionë të cilat janë qartësisht edhe për shkak të ligjit përgjegjëse për raportimin duke filluar nga institucioni i Kryeministratit, Këshilli i Ministrave, Ministritë, Sekretarët e Përgjithshëm, Bashkitë, institucionë të tjera të pavaruara. Po në mënyrë kapilare jam i sugurtë që kjo listë është shumë e gjatë edhe mendoj që nuk do të ishte nga pikëpamja praktike që ti bashkëngjitej një listë këtij projekt-akti sepse mund të rezultonte që në një moment të caktuar të identifikojmë edhe një intitucion tjetër të cilin nuk e kemi në këtë listë, dhe do të duhej pastaj që rregulatori rast pas rasti të plotësonë këtë listën. Kështu që unë do tiu rekomandoja ndoshta ndonjërit prej jush ose ndoshta vetë zonja Vukaj, mundet ta modifikonte si propozim, pra të ngelej pjesa e parë e propozimit dhe pastaj....

*Zbardhi materialin e inçizuar*

*Ardita VRIONI*

*P. Shillozi*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.24.12.2020*

**Znj.H.Vukaj:** Mund ta modifikojmë duke ngarkuar administratën e KQZ-së të përditësoj në vijimësi listën.

**Z.I.Celibashi:** Po, kjo ishte edhe ideja ime.

**Znj.I.Nano:** Të hartojë dhe të përditësoj.

**Znj.H.Vukaj:** Po edhe unë për këtë ide kisha.

**Z.I.Celibashi:** Në rregull! Faleminderit!

**Znj.H.Vukaj:** Faleminderit edhe ju!

**Znj.I.Nano:** Faleminderit! Zonja Vukaj, atëhere propozimi juaj konkret?

**Znj.H.Vukaj:** Të ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, të gjitha institucionet qendrore-vendore, të pavarur e të varësisë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi si aneks 1. Ngarkohet administrata e KQZ-së, të bëj përditësimin vijues të kësaj liste.

**Znj.I.Nano:** Ndjesë që po ndërhyjë, në momentin që nuk kemi një listë bashkëngjitur...

**Znj.H.Vukaj:** Zoti Celibashi sapo tha që kemi filluar ti sigurojmë këto institucione ...

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Ardita VRIONI*

*P. Celibashi*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.24.12.2020*

**Z.I.Celibashi:** Ne sot kemi listën e të gjitha ministrive dhe të gjitha bashkive, të identifikuara qartë sepse është qartësisht. Kështu që...

**Znj.H.Vukaj:** Pra, ky informacion të bëhet aneks...

**Z.I.Celibashi:** Do ti bashëngjisim këtë listë dhe pastaj bëjmë përditësimet.

**Znj.I.Nano:** Dhe fjalia: “Ngarkohet administrata e KQZ-së të përditësojë listën e institucioneve”. Në rregull, propozimi juaj zonja Vukaj është që ky nen të jetë....

**Znj.H.Vukaj:** Neni 12, më falni, më falni, një nen pararendës mbi kreun 6...

**Znj.I.Nano:** Pra, fundi i kreut të 5, neni 12?

**Znj.H.Vukaj:** Po, neni 12.

Dhe neni 12 dhe 13 të spostohen rregullisht sipas progresionit.

**Znj.I.Nano:** Në rregull! Të nderuar kolegë, votojmë propozimin e zonjës Vukaj!

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj,z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka!

**Miratohet!**

Kemi pa shqyrtuar nen për nen vetëm dy nenet e fundit të kreut 6. Ankimi, që tashmë është nen 13, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij. Neni 13

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Ardita VRIONI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.24.12.2020*

hyrja në fuqi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj,z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka!

**Miratohet!**

**Znj.I.Nano:** Është momenti të miratojmë aktin në tërsi.

**Kush është dakord me aktin pas shqyrtimit në parim nen për nen dhe ndryshimeve të pësuara?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj,z.Çakaj)

**Kundër:** S'ka!

**Miratohet!**

Faleminderit përpara se të mbyllim mbledhjen, do ti bashkohesha edhe unë urimit, për Krishtëlindje të bardha dhe të gëzuara. Nëse edhe kolegët dëshirojnë të përcjellin urime meqë jemi në këtë natë vigjilie të Krishtëlindjeve janë të ftuar ta bëjnë edhe më tej e mbyllim mbledhjen.

**Znj.H.Vukaj:** Gëzuar të gjithëve Krishtlindjen!

**Znj.I.Nano:** Faleminderit edhe njëhere, e mbyllim mbledhjen e Komisionit Rregulator të shtyrë nga data e djeshme. Ju falenderoj për pjesmarrjen dhe kontributin të gjithëve!

**Vendimi nr.9**

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Ardita VRIONI*

*P. Ardit VRIONI*